- Bashkëpunimi me shoqërinë civile ka qenë i mirë dhe gjithëpërfshirës.

- Bashkëpunimi me IDM, si organizatë e shoqërisë civile që po monitoronte procesin e hartimit të strategjisë ka qenë i mirë, i hapur dhe me kontribute të ndërsjella për të përmirësuar procesin dhe përmbajtjen e strategjisë.

Analiza e strategjisë

- Strategjia shpreh një synim ambicioz për përfaqësimin gjinor “rritja e përfaqësimit të të rinjve dhe grave në këshillat vendor me deri në 50% të përbërjes së këshillave”. Me nismën e një grupi deputetesh, ky synim u materializua me shtesën që iu bë pikës 6, të nenit 67, të Kodit Zgjedhor. Si rezultat i këtyre zhvillimeve, përfaqësimi gjinor në këshillat vendor ka marrë një dimension të ri shumë pozitiv.
- Mënyra e zgjedhjes së këshillit të qarkut shkaktonte pabarazi përfaqësimi dhe nuk është në përputhje me parimin “votim i barabartë”/fuqi e barabartë e votës. Zgjidhja që ka bërë ligji nr. 30/2015, datë 31.7.2000 përfaqësimit në këshillin e qarkut nuk është në një linjë me rekomandimet 201 (2006) dhe 349 (2013) të Kongresit.
- Pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje i është kushtuar një rëndësi e veçantë. Kjo është evidentuar në përmirësimet në përmbajtje që ka pësuar kjo çështje gjatë procesit të hartimit të strategjisë si dhe me miratimin e ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.
- Strukturat komunitare vlerësohen si të dobishme dhe me rëndësi për përmirësimin e demokracisë vendore, minimizimin e efekteve potencialisht negative të sistemit të konsoliduar territorial, plotësimin e nevojave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.
- Gjatë periudhës së tranzicionit, marrëdhëniet mes dy niveleve të qeverisjes kanë qenë gjithnjë në përmirësim. Gjatë kësaj periudhe marrëdhëniet janë shoqëruar edhe me probleme dhe kanë pasur ulje ngritje për shkak të mungesës së përvojës së bashkëpunimit, konflikteve politike, klimës së mosbesimit dhe mungesës së rregullimit me ligj të këtyre marrëdhënieve. Në strategji marrëdhëniet ndërqeveritare janë trajtuar mirë. Përshkruhet mënyra se si do të përmirësohen keto marrëdhënie, përcaktohet formalizimi me ligj i procesit të konsultimit dhe jepet angazhimi i qeverisë “Asnjë vendim që ndikon në qeverisjen vendore nuk do të merret pa u konsultuar më parë me përfaqësuesit e qeverisjes vendore”.
- Ligj Nr. 30/2015, datë 2.4.2015, ligjëron për herë të parë procesin e konsultimit dhe kjo është një gjë shumë pozitive. Pavarësisht nga kjo, ligji mbart disa problematika që lindin nga fakti se Këshilli i Ministrave është caktuar si autoriteti që përcakton strukturën, formën, mënyrën e organizimit, funksionimin, natyrën e çështjeve për konsultim dhe frekuencën kohore të procesit të konsultimeve mbi këtë bazë kanë lindur dyshimet se qeveria ruan kontrollin mbi konsultimin.
- Gjatë periudhës së tranzicionit, kompetencat e qeverisjes vendore në disa raste nuk janë të përcaktuara qartë, ka mbivendosje, nuk janë të plota dhe ka probleme në lirinë e ushtrimit të tyre. Strategjia përcakton disa synime ambicioze në fushën e kompetencave, në lidhje me funksionet e përbashkëta. Këto synime lidhen me qartësimin, rishikimin, harmonizimin dhe eliminimin e mbivendosjes së kompetencave.
- Strategjia nuk arrin të qartësojë përfundimisht ushtrimin e kompetencave të plota për çështjet vendore/çështjet publike në juridiksionin e qeverisjes vendore. Ajo nuk i shmanget dot

konfuzionit të krijuar nga terminologjia kompetenca “të veta” dhe “të deleguara” dhe funksione “të veta” dhe “të deleguara”.

- Strategjia ka përshkruar mirë dhe ka përcaktuar qartë objektivat dhe masat që do të ndërmerren për reformën administrativo-territoriale dhe zbatimin e saj. Në versionin përfundimtar të planit të veprimit ka një përmirësim rrënjësor në krahasim me versionin e tetorit 2014. Nga dy masa që kishte në versionin e tetorit 2014, sot kemi një kapitull “I. Reforma Administrativo-Territoriale” dhe 10 masa që përfshijnë të gjithë elementët e zbatimit të reformës territoriale.
- Krijimi i “Agjencisë së Zbatimit të Reformës Territoriale” me qëllim mbështetjen e njësive të reja të qeverisjes vendore është një veprim pozitiv.
- Strategjia përshkruan mirë qëllimin, objektivat specifike dhe masat për strukturat përfaqësuese, ekzekutive dhe komunitare. Pas 31 dhjetorit 2017, bashkitë e reja marrin kompetencën e plotë të riorganizimit administrativ sipas nevojave të komuniteteve vendore dhe efektshmërisë administrative dhe kjo shkon në përputhje me nenin 113 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Kartës Evropiane.
- Rreth 30% e masave të parashikuara në planin e veprimit lidhen me konsolidimin e kapaciteteve të njësive të qeverisjes vendore. Që në fillim grupi i punës, duke parë rëndësinë e këtij komponenti, ngriti nëngrupin tematik “Strukturat dhe marrëdhëniet ndërinstitucionale”, i cili ka bërë një punë shumë të mirë.
- Në Partneritetin Publik Privat (PPP) në nivel vendor është qartësuar fusha e bashkëpunimit, por mbetet e paqartë se çfarë lloj kompetencash do të ushtrohen nga palët.
- Në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, gjendja paraqitet tejmasë e vështirë në menaxhim dhe kërkon ndërhyrje emergjente afatshkurtër dhe ndërhyrje afatgjatë - jo vetëm “afatmesme” siç shprehet në strategji.
- Në sektorin e shërbimeve sociale dhe të përkujdesit shoqëror, do të ishte me shumë vlerë nëse do të përcaktohej më parë masa e financimit të këtij funksioni nga buxheti i shtetit, pra vlera në shifra e shportës e pastaj ndërhyrja nga buxhetet vendore.
- Në sektorin e strehimit social, roli i Komitetit Kombëtar të Strehimit nuk është përcaktuar qartë pasi nga funksioni konsultues ky komitet është veshur me autoritet vendimmarrës, veprim që çënon apo mbivendoset me kompetencat e qeverisjes vendore.

Perceptimet e aktorëve qendrorë dhe vendorë

- Aktorët qendrorë kanë pasur më tepër akses në dokumentin e strategjisë së decentralizimit sesa zyrtarët vendorë.
- Orientimi politik i njësive vendore shfaqet si faktor ndikues në perceptimet e zyrtarëve rreth aksesit të tyre në informacion.
- Ekziston një valë skepticizmi dhe mosbesimi në lidhje me përmbushjen e objektivave të strategjisë.
- Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve në fokus grupe shfaqti mosbesim tek strategjia. Një nga pjesëmarrësit u shpreh se “me strategjinë do të kemi vazhdimisht probleme pasi ... strategjitë hartohen dhe mbeten në sirtar...”. Njëkohësisht, pjesëmarrësit u shfaqën skeptikë ndaj qëllimeve

të qeverisë. U përmend se pushteti qendror nuk është i interesuar t'i lëshojë kompetencat njësive vendore.

- Pjesa më e madhe e zyrtarëve vendorë e kanë perceptuar procesin e diskutimit të Strategjisë së Decentralizimit disi të hapur dhe u shprehën disi të kënaqur me mënyrën sesi po ecën procesi i diskutimit.
- Komunat, krahasuar me bashkitë, kanë më shumë gjasa t'i cilësojnë proceset e hartimit dhe të diskutimit të strategjisë të mbyllura.
- Përfaqësuesit e shoqatave vendore shprehen mosbesues ndaj procesit të hartimit të strategjisë. Ata theksuan se organizmat konsultativë që synojnë pjesëmarrjen në vendimmarrje nuk funksionojnë pasi vendimet merren në mënyrë paraprake dhe kanë qëllime politike.
- Pjesa më e madhe e të anketuarve vendorë (47%) percepton se njëzia e tyre vendore nuk ka luajtur asnjë rol në procesin e hartimit të strategjisë. Zyrtarët e komunave në përgjithësi perceptojnë se kanë luajtur një rol shumë më të vogël në krahasim me zyrtarët e bashkive.
- Zyrtarët me orientim politik të djathtë kanë më shumë gjasa të deklarojnë një rol më të vogël në hartimin e strategjisë krahasuar me zyrtarët me orientim të majtë.
- Një numër i konsiderueshëm i komunave (45%) deklarojnë se strategjia përfaqëson interesat e qeverisë qendrore.
- Ndonëse gjysma e kampionit të aktorëve qendrorë ka qenë pjesë e Grupit Ndër-institucional të Punës, pjesa më e madhe e tyre cilëson se ka luajtur një rol të vogël në hartimin e strategjisë së decentralizimit.
- Perceptimet mbi impaktin e strategjisë së decentralizimit priret të shihen më pozitive në planin afatgjatë sesa në planin afatshkurtër.
- Impakti i strategjisë në forcimin e financave vendore dhe rritjen e autonomisë fiskale mbetet më i dyshimtë për zyrtarët vendorë.

Hyrje

Njësitë vendore në Shqipëri kanë hyrë në një fazë të re zhvillimi. Një sërë reformash kombëtare synojnë t'i transformojnë ato në qendra të zhvillimit politik, ekonomik, dhe social. Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (SKNDQV) (2015 – 2020) është një nga instrumentet përmes të cilit qeveria shqiptare synon ta realizojë një gjë të tillë. Kjo strategji është përballë dy sfidave kryesore: (a) të adresojë problemet që kanë karakterizuar decentralizimin në Shqipëri gjatë 15 viteve të fundit; dhe (b) të paraqesë hapa konkrete përmes të cilave decentralizimi realisht do të çojë në forcimin e njësisve vendore në Shqipëri. Por a do të çojë strategjia e propozuar në forcimin e qeverisjes vendore? Si e perceptojnë strategjinë zyrtarët vendorë dhe qendrorë? A do të çojë strategjia në një përsëritje të problemeve që kanë karakterizuar decentralizimin gjatë 15 viteve të fundit apo në një shkëputje prej tyre?

Për të adresuar këto pyetje, grupi i ekspertëve në IDM monitoroi procesin e hartimit të SKNDQV (2015 – 2020). Monitorimi u fokusua në tre dimensionet e decentralizimit – politik, administrativ, dhe financiar. Ekspertët ndoqën procesin e hartimit të strategjisë nga afër duke ndjekur takimet e grupeve dhe nëngrupeve të punës si dhe komunikimet midis tyre. Njëkohësisht, ekspertët analizuan përmbajtjen e drafteve të strategjisë për të kuptuar ndryshimet në kohë; nivelin në të cilin përmbajtja e strategjisë i është përgjigjur ndryshimeve të propozuara nga grupet e interesit. Një element thelbësor i analizës ishte shqyrtimi i perceptimeve të zyrtarëve në nivelin qendror dhe vendor. Raporti sjell perspektivat e aktorëve të ndryshëm duke vënë në pah ngjashmëritë dhe ndryshimet mes tyre.

Gjetjet tregojnë se procesi i hartimit të strategjisë së decentralizimit është karakterizuar nga një kombinim zhvillimesh – pozitive dhe negative. Për shembull, Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore dhe stafi i tij krijuan ura komunikimi me të zgjedhurit vendor, shoqërinë civile dhe ekspertët për përmirësimin e procesit të hartimit si dhe përmbajtjes së strategjisë së decentralizimit. Megjithatë, ka munguar bashkëpunimi mes pozitës dhe opozitës. Apo, strategjia përcakton disa synime ambicioze në fushën e kompetencave. Megjithatë, ajo nuk arrin të qartësojë ushtrimin e kompetencave të plota për çështjet vendore në juridiksionin e qeverisjes vendore. Njëkohësisht, studimi tregon se zyrtarët janë skeptikë dhe mosbesues në lidhje me përmbushjen e objektivave të strategjisë. Në mënyrë të veçantë, impakti i strategjisë në forcimin e financave vendore dhe rritjen e autonomisë fiskale mbetet i dyshimtë për zyrtarët vendorë.

Qëllimi i këtij raporti nuk është thjesht të paraqesë gjetje, por të inkurajojë individë, grupe, apo organizata të përfshira në fushën e qeverisjes vendore në Shqipëri t'i përdorin gjetjet me qëllimin fuqizimin e njësisve vendore: njësitë vendore të kenë autonominë dhe kapacitetet e duhura për të nxitur zhvillimin dhe bashkëpunimin midis tyre.

Pjesa në vazhdim e raportit është e ndarë në 4 kapituj. Kapitulli i parë fokusohet në historikun e decentralizimit në Shqipëri. Kapitulli i dytë fokusohet në metodologjinë e përdorur për grumbullimin

dhe analizimin e të dhënave. Kapitulli i tretë paraqet gjetjet, të cilat ndahen në tre seksione: procesi i hartimit të strategjisë, analiza e përmbajtjes së strategjisë, dhe shqyrtimi i perceptimeve të aktorëve qendrorë dhe vendorë. Kapitulli i fundit prezanton një sërë rekomandimesh sipas tre dimensioneve të decentralizimit – politik, administrativ, dhe financiar.

Historiku i decentralizimit në Shqipëri

Tradita shqiptare e qeverisjes vendore nuk është shumë e pasur dhe gjendet larg traditës së mirë të vendeve evropiane. Ajo ka tre periudha me karakteristika të veçanta.

Periudha e parë (vitet 1924-1938) përfaqëson fillimin e traditës shqiptare për qeverisjen vendore. Legjislacioni në vitet 1924-1938 evoluoi pozitivisht drejt krijimit të një pushteti vendor eficient.¹ Vlerësohet legjislacioni në fushën e taksave, bashkëpunimit mes sektorit publik dhe privat, zhvillimi i harmonizuar i zonave të ndryshme të vendit. Administrata ishte e vogël në numër dhe shumë efektive. Kjo periudhë e parë e qeverisjes vendore u pasua nga një periudha e dytë, ajo komuniste (vitet 1944-1990) ku kemi një perkeqësim të praktikës së krijuar të qeverisjes vendore. Gjatë kësaj periudhë asnjë parim i qeverisjes vendore nuk zbatohet. Qeverisja vendore drejtohet nga partia shtet. Në ideologjinë dhe teorinë politike të kohës pohohej me forcë si arritje demokratike “zëvendësimi i organeve të vetëqeverisjes lokale të trashëguara me krijesat e quajtura këshilla popullore apo komitete ekzekutive si organe të administratës shtetërore.”²

Me rënien e regjimit komunist në vitet 90', fillon periudha e tretë për qeverisjen vendore e cila mund të ndahet në dy faza. Faza e parë përfshin vitet 1992-2000, në të cilët filluan të formulohen dhe të implementohen konceptet e para demokratike të qeverisjes vendore. Në këtë periudhë parimi “Organe lokale të pushtetit”³ u zëvendësua me parimin “Organe të pushtetit lokal”⁴. Për herë të parë në Shqipëri organet e pushteti vendor u zgjodhën drejtpërsëdrejti nga populli me zgjedhje të lira, të përgjithshme, të barabarta dhe të fshehta.

Faza e dytë e kësaj periudhe (vitet 2000-2014) njihet edhe si vala e parë e decentralizimit. Kushtetuta e re në nenin 13 përcakton se “Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore.” Gjithashtu, në nenet 108-115, Kushtetuta përcakton nivelet e qeverisjes vendore, ngritjen dhe funksionimin e tyre, të drejtat dhe funksionet e organeve përfaqësuese. Me frymën e re kushtetuese, qeverisja vendore mori një mision dhe dimension të ri. U ratifikua Karta Evropiane e Autonomisë Vendore (tani e në vijim Karta Evropiane), e cila solli detyrimin për implementimin e normave dhe standardeve evropiane për vetëqeverisjen në legjislacionin e brendshëm. U miratua ligji nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (tani e në vijim ligji organik), i cili normoi misionin dhe të drejtat e njërive të qeverisjes vendore, kompetencat dhe funksionet, burimet dhe shpenzimet, bashkëpunimin dhe bashkëveprimin me institucionet e tjera qeveritare. U miratuan ligji nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”; ligji nr. 9869, datë 4.2.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore” ku njërive të qeverisjes vendore iu dhanë

¹ Isaraj, A. (1998). *Një Vështrim Historik i Traditës së Qeverisjes Lokale në Shqipëri*.

² Ibid.

³ Ligji Nr.5506, datë 28.12.1976, “Kushtetuta e RPSSH” Pjesa e dytë, kap II.

⁴ Ligji Nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”.

burimet financiare për ushtrimin e funksioneve të tyre dhe u normuan rregullat për grumbullimin, administrimin dhe shpenzimin e burimeve. U miratua ligjinr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” ku njësitë të qeverisjes vendore iu dhanë pronat dhe instrumentat e duhura ligjore për ushtrimin e së drejtës së pronës. Gjithashtu u miratua për herë të parë një strategji për decentralizimin dhe autonominë vendore, e cila përcaktoi vizionin, rrugët, instrumentat e ngritjes dhe fuqizimit të qeverisjes vendore në Shqipëri. Vlen të theksohet se për herë të parë qeveria qendrore dhe qeveritë vendore bënë një marrëveshje politike ku dakorduan për krijimin e Komitetit Kombëtar për Decentralizimin, i cili me konsensus miratonte drejtimet politike dhe parimet e decentralizimit dhe Grupit të Ekspertëve për Decentralizimin me detyrë formulimin e strategjisë dhe monitorimin e saj.

Me miratimin e ligjit nr. 115/2014, datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësitë të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” qeverisja vendore merr një dimension të ri. Reforma administrative - territoriale u planifikua dhe do të zbatohet në bazë të tre objektivave strategjikë: i) përmirësimi i shërbimeve për qytetarët në nivel vendor, ii) rritja e efijencës dhe mirëqeverisjes në nivel vendor, iii) fuqizimi i qeverisjes vendore, qytetarëve dhe komuniteteve. Me miratimin e Urdhërit nr. 69, datë 13.02.2014 “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e strategjisë ndërsektoriale të decentralizimit dhe qeverisjes vendore” fillon puna për hartimin e strategjisë së re të decentralizimit. Këtu fillon dhe vala e dytë e decentralizimit në Shqipëri.

Periudha 2000-2014 mund të përfikuzohet si periudha e ngritjes së qeverisjes vendore në bazë të kushtetutës, Kartës Evropiane dhe ligjit organik. Kjo periudhë, me gjithë sukseset e padiskutueshme të arritura, mbart në vetvete disa probleme që kërkojnë zgjidhje nëpërmjet strategjisë së re.

Më poshtë do të prezantohen problematikat që kanë karakterizuar të tre dimensionet e decentralizimit – dimensionin politik, administrativ dhe fiskal – gjatë kësaj periudhe.

Dimensioni politik

Analiza ka përfshirë shqyrtimin e parimeve kryesore të dimensionit politik të decentralizimit dhe të mekanizmave/instrumentave që bëjnë të mundur implementimin e tyre. Kushtetuta, Karta Evropiane, ligji organik dhe vendimi nr. 29, datë 21.12.2006 i Gjykatës Kushtetuese mbi interpretimin përfundimtar të nenit 13 të Kushtetutës, përbëjnë filozofinë, frymën, parimet dhe instrumentat për ngritjen dhe funksionimin e qeverisjes vendore, të drejtat, kompetencat, funksionet dhe burimet financiare të saj. Nga ky kuadër kushtetues dhe ligjor buron dhe dimensionin politik i decentralizimit. Ai rrjedh nga e drejta e komuniteteve vendore për t’u vetëqeverisur, e drejtë të cilën e ushtrojnë nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur me votim ose nëpërmjet pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendimarrje. Për të realizuar vetëqeverisjen, komunitetet vendore duhet të zgjedhin përfaqësuesit e tyre dhe këta duhet të kenë: (i) të drejtën për të rregulluar e drejtuar një pjesë të mirë të çështjeve publike në bazë të parimit të subsidiaritetit; (ii) kompetenca të plota dhe liri për rregulluar dhe administruar në mënyrë të pavarur çështjet vendore brenda juridiksionit të

tyre; (iii) burime të mjaftueshme për ushtrimin e veprimtarisë së tyre; (iv) të drejtën e bashkëpunimit dhe të marrëdhënieve mes dy niveleve të qeverisjes. Analiza e problemeve të dimensionit politik që përshkruhet në vijim, në mënyrë të përmbledhur përfshin (i) vetëqeverisjen nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur dhe pjesëmarrjes qytetare në vendimarrje ose komponenti demokratik (përfaqësimi dhe pjesëmarrja); (ii) marrëdhëniet mes qeverisë qendrore dhe vendore; dhe (iii) kompetencat dhe problemet në ushtrimin e tyre.

Vetëqeverisja nëpërmjet përfaqësuesve dhe pjesëmarrjes qytetare

Në analizën e kësaj çështjeje, ne jemi fokusuar në tre çështje: (1) përfaqësimi; (2) pjesëmarrja qytetare në vendimarrje dhe (3) referendumet.

Përfaqësimi është një element kryesor i komponentit demokratik, i cili rregullohet nëpërmjet Kushtetutës, Kodit Zgjedhor dhe ligjit organik. Ai bazohet në 5 parimet bazë të trashëgimisë elektorale evropiane (votimi i përgjithshëm, i barabartë, i lirë, i fshehtë dhe i drejtpërdrejtë), por ka vend për përmirësime të mëtejshme. Në vijim disa argumenta.

Përfaqësimi gjinor në organet e zgjedhura të qeverisjes vendore është larg parimit të përfaqësimit të barabartë gjinor në vendimmarrjen politike dhe publike të përkufizuar nga ligji nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri” dhe akoma më larg angazhimit që kanë marrë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës nëpërmjet objektivit 4 të Strategjisë së Barazisë Gjinore 2014-2017 e cila synon arritjen e pjesëmarrjes së balancuar të grave dhe burrave në vendimmarrjen politike e publike (përfaqësimi nuk duhet të jetë poshtë 40 %).⁵ Të dhënat nga zgjedhjet vendore të vitit 2011 tregojnë se nga 6,146 këshilltarëve fitues për këshillat e komunave dhe bashkive (përfshirë 11 minibashkitë) vetëm 753 ose 12.3% ishin gra fituese. Në 88 njësi të qeverisjes vendore nuk ka asnjë grua fituese. Në 367 njësi të qeverisjes vendore (përfshirë 11 minibashkitë) nuk u arrit kuota 30 %. Në vetëm 17 njësi të qeverisjes vendore gratë dolën fituese në kuotën mbi 30%. Në listat e kandidatëve për kryetar komune/ bashkie (përfshirë të minibashkive) kishte 872 kandidatë dhe nga këto vetëm 14 ose 1.6 % ishin gra. Nga 384 kryetar fitues vetëm 6 ose 1.6 % ishin gra fituese.

Mënyra e sotme e zgjedhjes së këshillit të qarkut shkakton pabarazi përfaqësimi dhe është në kundërshtim me parimin “votim i barabartë”/fuqi e barabartë e votës. Problemi është evidentuar nga Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale i Këshillit të Evropës (tani e në vijim Kongresi), i cili në dy raste në rekomandimet për Shqipërinë ka përfshirë rekomandimin për ndryshimin e mënyrës së zgjedhjes së Këshillit të qarkut si dhe nga Banka Botërore (BB) e cila në raportin⁶ e saj citon “Në Shqipëri, çështja e përfaqësimit përbën një sfidë që herët a vonë duhet të zgjidhet...”.

Neni 110 të Kushtetutës ka përcaktuar “Bashkitë dhe komunat delegojnë anëtarë në këshillin e qarkut **në përpjesëtim me popullsinë** e tyre”. Në bazë të këtij parimi kushtetues “*në përpjesëtim me*

⁵ Objektivit 4 në *Strategjia e barazisë gjinore 2014-2017*. Këshilli i Evropës. .

⁶ Raport Nr: 27885-ALB *Shqipëria: Decentralizimi në tranzicion II*, fq.12.

popullsinë” nenit 50 i ligjit organik jep formulën e përcaktimit të numrit të anëtarëve të këshillit të Qarkut. Kjo formulëka prodhuar një pabarazi në përfaqësim të popullsisë në këshill të qarkut, sepse të dhënat⁷ nga zgjedhjet vendore të vitit 2011 flasin se 77,075 banorë të bashkisë Shkodër përfaqësohen në Këshillin e Qarkut Shkodër me 6 këshilltarë, ndërkohë 77,832 banorë të 27 njësive të tjera përfaqësohen me 43 këshilltarë; 113,249 banorë të Bashkisë Durrës përfaqësohen në Këshillin e Qarkut me 8 këshilltarë, ndërkohë 112,929 banorë të 14 njësive të tjera përfaqësohen me 34 këshilltarë. E njëjta dukuri vërehet në të gjithë qarqet e Shqipërisë.

Një element i rëndësishëm i komponentit demokratik është **pjesëmarrja e qytetarëve në vendimarrje**. Qeverisja vendore duhet t’u garantojë qytetarëve: (i) informim në kohë, në sasi dhe në cilësinë e duhur; (ii) vendosjen e çështjeve të tyre prioritare në axhendën e vendimarrjes; (iii) shprehjen e opinionit dhe pikëpamjeve të tyre për çështje vendore; (iv) ushtrimin e autoritetit të tyre në forma të mundshme dhe të përshtashme. Sipas kodit të praktikës së mirë për pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes⁸ ekzistojnë katër nivele graduale të pjesëmarrjes, nga niveli më i ulët i pjesëmarrjes deri tek ai më i lartë. Këto janë informimi, konsultimi, dialogu dhe partneritetidhe as dispozita që rregullojnë peticionin dhe iniciativën qytetare. Nenit 35 i ligjit organik rregullohet dy nivelet e para të pjesëmarrjes qytetare (informimi dhe konsultimi) por ligji nuk ka dispozita që rregullojnë dhe mbështesin pjesëmarrjen aktive qytetare (dialogu dhe partneriteti). Shqipëria akoma nuk ka ratifikuar protokollin shtesë të Kartës Evropiane për të drejtën për pjesëmarrje në punët e një organi vendor. Këshilli i Ministrave, më 16.06.2010 ka miratuar në parim këtë protokoll, por vendimi i tij nuk është botuar në fletoren zyrtare dhe nuk është ratifikuar nga Kuvendi.

E drejta e vetëqeverisjes nëpërmjet referendumeve nuk është ushtruar deri më sot nga qytetarët për shkak se kuadri ligjor mbart probleme dhe vështirësi në zbatim. Çështja e referendumeve vendore u bë objekt diskutimi nga shumë njësi të qeverisjes vendore dhe nga shoqatat e të zgjedhurve vendor gjatë procesit të reformës administrative – territoriale të cilët kërkuan respektimin e të drejtës së qytetarëve për t’u shprehur për ndryshimin e kufijve administrativë.

Dispozitat për referendumet janë miratuar në vitin 2003 si pjesë integrale e Kodit Zgjedhor dhe që nga ajo kohë nuk kanë pësuar ndryshime, ndonëse Kodi Zgjedhor ka pësuar ndryshime disa herë. Gjithashtu, nga Komisioni i Venecias⁹ dhe misioni OSBE/ODIHR ka pasur rekomandime për të ndryshuar disa nga dispozitat për referendumet. Në dispozitat aktuale për referendumet mungon lista e çështjeve vendore për të cilat qytetarët mund të realizojnë vetëqeverisjen nëpërmjet referendumeve vendore dhe e drejta e thirrjes së referendumit nga autoritetet vendore. Procedurat për realizimin e referendumit janë norma juridike të ndërlikuara për qytetarët dhe autoritet vendore. Përfshirja e KQZ, Presidentit të Republikës dhe Gjykatës Kushtetuese në vendimarrjen dhe

⁷Të dhënat e popullsisë në bazë të të dhënave të INSTAT-it (Censusi 2011).

⁸Teksti i Kodit të praktikës së mirë: http://coe.int/t/ngo/Source/Code_English_final.pdf.

⁹Venice Commission and OSCE/ODIHR. *Joint Recommendations on the Electoral Law and the Electoral Administration in Albania*. Opinion no. 273 / 2004.

realizimin e referendumit vendor është pengesë për vetëqeverisjen vendore. Në shumë shtete e drejta e vendimarrjes dhe organizimit të referendumeve vendore iu përket autoriteteve vendore.

Marrëdhëniet mes qeverisë qendrore dhe vendore

Gjatë periudhës së tranzicionit marrëdhëniet mes dy niveleve të qeverisjes ka qenë gjithnjë në përmirësim si pasojë e njohjes dhe zbatimit të parimeve (të vetëqeverisjes, subsidiaritetit, ligjshmërisë dhe delegimit të kompetencave) dhe ngritjes së mekanizmave (të bashkëpunimit, informimit, konsultimit etj) që mbështesin, lehtësojnë, realizojnë dhe rregullojnë keto marrëdhënie. Pranohet që gjatë kësaj periudhe marrëdhënit janë shoqëruar edhe me problem dhe kanë pasur ulje ngritje për shkak të mungesës së përvojës së bashkëpunimit, konflikteve politike, klimës së mosbesimit dhe mungesës së rregullimit me ligj të këtyre marrëdhënieve.

Në analizën që ne i bëmë kësaj çështje evidentuam se (i) Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj, nr. 29, datë 21.12.2006, ka bërë një vlerësim dhe interpretimin përfundimtar të nenit 13 të Kushtetutës nga i cili veçojmë: “Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të qeverisjes vendore si dhe raporti që ajo ka me pushtetin qendror varen nga kuptimi kushtetues dhe ligjor që u jepet decentralizimit të pushtetit, autonomisë vendore dhe vetëqeverisjes” (ii) Rekomandimi 228 (2007)¹⁰ shtojca I, neni 11, sugjeron përfshirjen e autoriteteve lokale në procesin e vendimarrjes për çështjet që u përkasin atyre. Kongresi kërkon që e drejta e autoriteteve lokale për t’u përfaqësuar në procesin e vendimarrjes nëpërmjet shoqatave të tyre të njihet me ligj (iii) rekomandimi 201 (2006) pika 7/d, ju rekomandon autoriteteve shqiptare “Të institucionalizohet konsultimi dhe pjesëmarrja e autoriteteve lokale dhe rajonale në procesin e decentralizimit”¹¹ (iv) Rekomandimi 349 (2013)¹² shprehet se : “nuk ka rregulla të qarta për pjesëmarrjen e shoqatave të autoriteteve vendore në procesin e konsultimit”si dhe rekomandon “vendosjen e një një dispozite specifike në ligjin nr. 8652 me qëllim zyrtarizimin e procesit të konsultimit dhe për të siguruar konsultimin "në kohën e duhur dhe në mënyrë të përshtatshme, në çështjet që u përkasin atyre drejtpërdrejt", siç kërkohet nga Neni 4 paragrafi 6 i Kartës.

Gjatë viteve të fundit, edhe pse qëndrimi zyrtar i qeverive ka qenë të decentralizojë pushtetin, herë pas here vërehen **tendencë centralizuese** nga ana e qeverive. Ky fenomen del na pah përmes disa ligjeve dhe akteve nënligjore që kanë propozuar dhe miratuar qeveri të ndryshme si psh kuadri ligjor që rregullon veprimtarinë e Inspektoriatit Urbanistik Kombëtar, Këshillin Kombëtar të Territorit, sistemin e taksave vendore, transfertat e pakushtëzuara, etj.

Koncepti i qarqeve ende mbetet një **“fushë e paplotësuar.”**Ky është konstatimi i Bankës Botërore¹³ i bërë që në vitin 2004, por që është aktual edhe sot sepse territori, kompetencat, funksionet, burimet, kapacitetet dhe përfaqësimi akoma janë larg parimit të vetëqeverisje rajonale europiane.

¹⁰ Recommendation 228. (2007). *Draft additional protocol to the European Charter of Local Self-Government.*

¹¹ Rekomandimi 201. (2006). *Mbi demokracinë lokale dhe rajonale në Shqipëri.*

¹² Rekomandimi 349. (2013). *Mbi demokracinë lokale dhe rajonale në Shqipëri.*

¹³ Raport Nr: 27885-ALB *Shqipëria: Decentralizimi në tranzicion II*, fq.18.

Në analizën që ne i bëmë kuadrit ligjor evidentuam se kushtetuta përcakton se “Qarku është njësi ku ndërtohen e zbatohen politikat rajonale dhe ku ato harmonizohen me politikën shtetërore”¹⁴. Ligji organik shprehet se “Funksionet e veta të qarkut janë ndërtimi dhe zbatimi i politikave rajonale dhe harmonizimi i tyre me politikat shtetërore në nivel qarku, si dhe çdo funksion tjetër i vet i dhënë me ligj”. Vendimi i KM nr. 773, datë 14.11.2007 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për zhvillimin rajonal, për periudhën 2008-2013” përcaktoj vizionin, objektivat strategjike, prioritetet dhe strukturat për zhvillimin rajonal. Ligji nr. 115/2014, datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në RSH” ripërcakton 12 qarqe si njësi të qeverisjes vendore pa prekur dimensionin e sotëm territorial të tyre.

Kongresi ka shprehur dy herë shqetësime dhe rekomandime për qarqet, si “ekzistencën e boshllëqeve në përcaktimin e rolit dhe funksioneve të tyre në sistemin politik dhe administrative, mungesën e burimeve financiare dhe administrative¹⁵” dhe se “b. bashkëjetesa e këshillave të qarqeve dhe prefektëve si struktura paralele në çdo qark e bën të paqartë faktin se cilat kompetenca janë nën mandatin ekskluziv të këshillave...” dhe “c. ligji organik rregullon në mënyrë të paqartë strukturën, rolet dhe përgjegjësitë e organeve vendore dhe të atyre rajonale¹⁶”.

Kompetencat dhe problemet në ushtrimin e tyre

Kompetencat e qeverisjes vendore në disa raste nuk janë të përcaktuara qartë, ka mbivendosje, nuk janë të plota dhe ka probleme në lirinë e ushtrimit të tyre.

Në analizën që ne i bëmë kuadrit ligjor evidentuam se kushtetuta përcakton se këshillat vendor rregullojnë dhe administrojnë në mënyrë të pavarur çështjet vendore brenda juridiksionit të tyre. Ligji organik përcakton dy kategori kompetencash (të veta dhe të deleguara) dhe i ndan ato në lloje (administrative, investimi, rregullatore, shërbimi). Karta Evropiane përcakton se “bashkësitë vendore gëzojnë, brenda ligjit, liri të plotë për të ushtruar iniciativën e tyre për çdo çështje që nuk është jashtë kompetencës së tyre dhe kompetencat që u besohen bashkësive vendore normalisht duhet të jenë të plota”. Nga raporti “Analiza e Ushtrimit të Funksioneve të Veta të Qeverisjes Vendore në Shqipëri¹⁷” del se qeverisja vendore për disa funksione të veta ka dhe ushtron kompetenca të plota administrative, shërbimi, investimi dhe rregullatore dhe në disa funksione të tjera nuk ka kompetenca të plota, ato i ushtron pjesërisht. Nga raporti “Analiza e Zbatimit të Funksioneve të Përbashkëta të Pushtetit Vendor në Shqipëri¹⁸” për funksionet përbashkëta “Nuk përcaktohen qartë kompetencat”, dhe vija ndarëse që ka secili nivel. Kjo ka krijuar paqartësi dhe mungesë efience, paralelizma kompetencash brenda një sistemi”. Nga studimi i Dafflon¹⁹ evidentohet fakti i konfuzionit që krijohet nga përdorimi për

¹⁴Neni 110 pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë..

¹⁵Rekomandimi 201 (2006) pika 14 Mbi demokracinë lokale dhe rajonale në Shqipëri.

¹⁶Rekomandimi 349 (2013) pika 6.b dhe c Mbi demokracinë lokale dhe rajonale në Shqipëri.

¹⁷Vokopola, E. (2014). *Draft Analiza e Ushtrimit të Funksioneve të Veta të Qeverisjes Vendore në Shqipëri*.

¹⁸Trebicka dhe Apostoli (2014). *Analiza e Zbatimit të Funksioneve të Përbashkëta të Pushtetit Vendor në Shqipëri*.

¹⁹Dafflon. *Probleme konceptuale në përcaktimin e funksioneve në vendet e Europës Juglindore: Rasti i Shqipërisë*.

“kompetenca”, dhe për “funksionet” i termave “e veta” dhe “të deleguara” dhe kjo ndarje kufizon konceptin e kompetencës së plotë në rastet e funksionit lokal. Kongresi nëpërmjet rekomandimit 349 (2013) ka kërkuar qartësimin e kompetencave të organeve vendore dhe rajonale, duke rishikuar veçanërisht nenet 2, 7, 8, 9 dhe 10 të ligjit organik.

Nga qershori 2015 Shqipëria do të kalojë në sistemin me njësi më të mëdha vendore, i njohur ndryshe si sistemi i konsolidimit territorial. Sistemi i ri, krahas efekteve të shumta positive ka potencialisht edhe disa efekte të mundshme negative në demokracinë vendore. Në sistemin e konsoliduar territorial (i) rritet distanca mes qytetarit dhe përfaqësuesit të tij; (ii) ulet numri i përfaqësuesve për numër banor; (iii) ulet njohja dhe besimi mes qytetarit dhe përfaqësuesit të tij; (iv) ulet llogaridhënia dhe transparencja; (v) ka vështirësi në përfaqësimin e interesave të grupeve dhe komuniteteve të largëta²⁰. Minimizimi i deficitit demokratik lidhet ngushtësisht me qeverisjen e mirë, parimet dhe instrumentat e implementimit të saj dhe me ngritjen, funksionimin dhe konsolidimin e strukturave me bazë komunitare.

Dimensioni administrativ

Ligji organik “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” ka vendosur kornizën e procesit të decentralizimit, mbi të cilën u zhvillua kuadri ligjor që lidhet me procesin e decentralizimit. Procesi decentralizues në fushën e funksioneve dhe kompetencave përkatëse për të realizuar këto funksione, mishërohet në këtë ligj organik. Ai konsolidon në mënyrë të zgjeruar qeverisjen vendore si autoritet administrativ, shërbimi, investimi dhe si institucion rregullator në fushën e infrastrukturës publike e të shërbimeveku ndër më të rëndësishmit mund të përmendim furnizimin me ujë të pijshëm, ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore, transportin publik vendor, planifikimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, etj.

Qeverisja vendore u karakterizua nga një fragmentarizëm i lartë në të gjithë vendin. Një e pesta e popullsisë së Shqipërisë jetojnë në 232 njësi të qeverisjes vendore. Afërsisht 75% e totalit të NjQV-ve kanë më pak se 5,000 banorë. Kostot tepër të larta të shërbimeve për qytetarët e kanë vështirësuar ofrimin e shërbimeve bazë ose pamundësuar atë. Fenomeni i shërbimeve jo cilësore ndikohet edhe nga kapacitetet e kufizuara njerëzore të njësitëve qeverisjes vendore. Paqartësia në ndarjen e funksioneve të përbashkëta dhe roli i paqartë i qarqeve në ushtrimin e funksioneve vendore ka zbehur performancën e qeverisjes vendore në Shqipëri në vitet post-diktaturë.

Analiza e problemeve të dimensionit administrativ ka marrë për shqyrtim problematika të qeverisjes vendore pas miratimit të ligjit organik ku përfshihen pika të caktuara të lidhura me funksionet e qeverisjes vendore. Si dokumenta referuese janë marrë konkluzionet e Rekomandimeve të Kongresit të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale Evropiane 201 (2006) dhe 349 (2013).

²⁰ Swianiewicz, P. *Is territorial consolidation – a necessary pre-condition for further decentralization?*

Përgjegjësitë e Njësive të Qeverisjes Vendore

Kongresi i Autoriteteve Vendore dhe Rajonale tërheq vëmendjen se “dispozitat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore nuk janë zbatuar plotësisht”. Kongresi sjell në vëmendje autoriteteve qendrore se autoritetet vendore “duhet të kenësa më tepër të jetë e mundur, përgjegjësi të plota (sipas nenit 4.4 të Kartës) të ndara ndërmjet organeve qendrore dhe atyre vendore, duke u bazuar në respektin ndaj parimit të subsidiaritetit”. Gjithashtu rekomandohet kalimi në mënyrë graduale i pushtetit ekzekutiv dhe ndarja e funksioneve midis niveleve të qeverisjes vendore me ato qendrore, duke vënë theksin në decentralizimin e furnizimit me ujë dhe sistemit të kanalizimeve si funksione të veta të tyre, duke pasur në vëmendje implikimet financiare në transferimin e tyre.

Në Rekomandimin 349 Kongresi shpreh shqetësimin e tij se “ligji organik rregullon në mënyrë të paqartë strukturën, rolet dhe përgjegjësitë e organeve vendore dhe rajonale... organet vendore nuk kanë burime financiare ose të ardhura vendore në përputhje me kompetencat e veta dhe me kompetencat e ndara, gjë e cila nuk është në përputhje me Nenin 9, Paragrafi 2 të Kartës Evropiane”.

Një nga problemet e qeverisjes vendore ka qënë pamundësia për të përdorur të drejtat e dhëna me ligj. Në vitin 2000, hartimi i ligjit organik dhe ndarja administrativo-territoriale nuk u bazua në studime apo analiza të thelluara të kapacitetit dhe aftësive të njësive të qeverisjes për të kryer funksionet dhe kompetencat e decentralizuara. Decentralizimi u bazua në konceptin e barazisë për funksionet dhe kompetencat për të gjitha njësitë vendore duke mos bërë dallim në burimet që zotëroheshin, në madhësinë e njësive të qeverisjes vendore apo në kapacitetet e tyre për kryer këto funksione. Komunitetet vendore si edhe përfaqësuesit e qeverisjes vendore nuk ishin pjesë e tryezave konsultuese dhe ndarja erdhi si detyrim kushtetues dhe detyrim i Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore. Ligji organik përcakton në nenin 8, pika c, se bashkitë dhe komunat “krijojnë struktura administrative për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tyre, sipas ligjeve në fuqi”. Ligji sillte një zhvillim asimetrik ku fshatrat apo bashkësi fshatrash u quajtën “komuna” dhe gëzuan të drejta të barabarta ligjore me qytetet të cilat u quajtën “bashki”.

Një pjesë e komunave, duke qënë të vogla, nuk arritën të ndërtonin kapacitete administrative të përshtatshme për ushtrimin e kompetencave. Pjesa tjetër e komunave, më të mëdha në numër popullate, u rritën dhe fuqizuan duke u krahasuar me qytetet mesatare të Shqipërisë në lidhje me burimet dhe autoritetin e tyre ekzekutiv. Në komunat e vogla administrata e pamjaftueshme nga ana sasiore dhe mungesa e kapaciteteve ishte një nga arsyt kryesore të mungesës së efikasitetit në kryerjen e shërbimeve publike në nivel vendor.

Shumë prej bashkive dhe komunave të vogla kishin staf të limituar përgjegjës për funksione të tilla si shërbimet në infrastrukturë, planifikimin territorial, kulturën apo mjedisin. Në njësi të tjera më të mëdha në numër të popullatës problem kryesor ishte cilësia e stafit. Mund të themi se kapacitetet e kufizuara njerëzore që arritën të afrojnë njësitë vendore, e bënë të pamundur ushtrimin e funksioneve

vendore dhe zbehën aftësinë e këtyre njësive për të gjeneruar e grumbulluar të ardhura e për të ofruar shërbime.

Sipas relacionit për projektligjin “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive vendore në Republikën e Shqipërisë” (2014), njësitë vendore në Shqipëri shpenzojnë 27% të buxhetit të tyre për investime kapitale dhe 37% për pagat e punonjësve. Këto shifra përkeqësohen sipas ndarjes së njësive në kategorizime më të detajuara: 40 NjQV shpenzojnë mbi 80% të buxhetit të tyre vetëm për pagat e punonjësve, ndërsa 230 NjQV (63% e NjQV-ve dhe që përfaqësojnë 34% të popullsisë së vendit) shpenzojnë mbi 60% të buxhetit të tyre për pagat e punonjëve.

Ligji organik cilëson se “për kryerjen e shërbimeve specifike në emër dhe në dobi të bashkësive përkatëse, dy ose më shumë njësi të qeverisjes vendore mund të ushtrojnë së bashku çdo funksion që u është dhënë atyre me ligj, nëpërmjet zbatimit të marrëveshjeve ose kontratave të përbashkëta, delegimit të kompetencave dhe përgjegjësisë të veçanta njëra-tjetrës ose kontraktimit me një palë të tretë”. Rastet e zbatimit të kësaj pjese të ligjit kanë qënë të pakta dhe të sforcuara dhe kanë patur ndihmën dhe kontributin e disa organizatave ndërkombëtare për të mbështetur nisma të tilla. NjQV-të nuk kanë patur vullnetin për të deleguar kompetencat e tyre në një nivel tjetër të qeverisjes vendore, në rastet kur kanë mundur të ofrojnë shërbimet tek qytetarët e tyre. Disa raste të rralla për bashkim të disa njësive fqinje për të kryer shërbime së bashku nuk kanë legjitimuar të drejtën e bashkëpunimit të lirë të shprehur në ligj.

Ligji organik përcakton se “njësitë e qeverisjes vendore, ushtrojnë të drejtën e pronësisë. Ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të tyre, si dhe ushtrojnë të drejta të tjera sipas mënyrës së përcaktuar me ligj”. Procesi i tejzgjatur i transferimit të pronave publike nuk dha efektin e duhur për ta kthyer këtë të drejtë në një nga faktorët kryesorë të krijimit të të ardhurave të njësive vendore. Konflikti me pronarët më të hershëm para ndryshimit të sistemit e ka bërë akoma më të vështirë këtë proces, sidomos në zonat urbane.

Dimensioni financiar

Sipas informacioneve të ekipit të ekspertëve që kanë hartuar strategjinë e decentralizimit, gjatë periudhës nëntor 2014 – shkurt 2015 janë hedhur hapa të mëtejshëm në formulimin e objektivave të decentralizimit fiskal dhe strukturës së financimit të njësive të qeverisjes vendore, të cilat përfshijnë mes të tjerash riformulimin e ligjit organik të qeverisjes vendore, si edhe rishikimin e plote të kuadrit financiar. Puna për strukturimin e ri të transfertave të pakushtëzuara me bazë formule ekualizuese duket të ketë filluar tashmë me mbështetjen teknike të programit PLGP të financuar nga USAID. Megjithatë, dokumentet e punës dhe të ndërmjetme që po punohen nga ekspertët teknikë nuk janë ende të disponueshme për publikun në kohën e hartimit të kësaj analize. Si rezultat, një pjesë e vlerësimeve dhe/ose rezervave të përmbledhura këtu mund të marrin përgjigje të ndryshme në një kohë të dytë kur informacioni të jetë më i plotë.

Gjendja ekzistuese të strukturës së financimit të njësive të qeverisjes vendore

Në një analizë përmbledhëse të ecurisë së decentralizimit fiskal ndër vite, vërehet se njësitë e qeverisjes vendore administrojnë një pjesë shumë të vogël fondesh krahasuar me Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB) si edhe me shpenzimet e konsoliduara publike. Me gjithë ndryshimet thelbësore në strukturën e të ardhurave vendore (granti i pakushtëzuar dhe ligji i taksave dhe tarifave vendore) në sajë të të cilave pati rritje të ndjeshme të të ardhurave diskrecionale në periudhën 2002 – 2007, të ardhurat dhe shpenzimet vendore në Shqipëri mbeten modeste qoftë në raport me numrin e banorëve (të ardhura për frymë) ashtu edhe në raport me nivelet kombëtare (shpenzime publike dhe PBB). Në veçanti, analiza krahasimore e të ardhurave për frymë në NjQV-të shqiptare me vendet e rajonit është mjaft interesante, por do të ishte me vlerë të sqarohet se për çfarë të ardhurash bëhet fjalë (të ardhura të veta; të ardhura diskrecionale apo të ardhura totale të cilat përfshijnë çdo lloj burimi qoftë edhe të kushtëzuar) si edhe të citoheshin burimet nga janë marrë të dhënat për vendet e rajonit. Kjo do të vinte në pah jo vetëm besueshmërinë e të dhënave por edhe do të krijonte mundësinë që lexuesit të vlerësonin nëse baza e krahasimit është e njëjtë duke pasur parasysh ndryshimet jo të vogla në organizimin dhe strukturën e financimit të pushtetit vendor në rajon dhe Evropë.

Analiza e ecurisë së decentralizimit fiskal vijon me një paraqitje të burimeve kryesore të të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore:

Të ardhurat e veta

Taksa e pasurisë trajtohet në veçanti në këtë seksion i cili nënvizon se taksa e pasurisë është “alternativa më e mirë e mundshme për përmirësimin e të ardhurave të veta të NjQV”. Krahas sfidave të përmendura për realizimin e kësaj takse si identifikimi dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme do të kishte qenë me vlerë të përmendëj edhe çështja e shumë diskutuar e bazës dhe nivelit të taksës së pasurisë. Prej vitesh diskutohet se niveli i taksës së pasurisë është tepër i ulët dhe shpeshherë kostot administrative për mbledhjen e saj janë shumë pranë ose tejkalojnë të hyrat potenciale. Gjithashtu, shumë aktorë advokojnë në favor të kalimit të bazës së taksës drejt vlerës së tregut si edhe futjes së taksës mbi truallin urban të pashfrytëzuar. Një propozim ligjor i para disa viteve për rritjen e nivelit të taksës së pasurisë i cili arriti në parlament me kompromis politik të dy partive kryesore u rrëzua në momentin e fundit. Ndërkohë, në fund të vitit 2013 me disa ndryshime në nivelin e taksave të pasurisë u rrit shumëfish niveli i taksës në disa terriore të quajtur si “fshatra turistike” në bregdet, ndërkohë që taksa e pasurisë për ndërtesat në qytetet kryesore të vendit mbetet në nivele mjaft modeste; duke krijuar pabarazi të theksuara në sistem.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë ka qenë një burim domethënës i të ardhurave deri në vitin 2010 kur me shenjat e para të krizës ekonomike dhe rënien e intensitetit të ndërtimeve, hyrjet nga kjo taksë ranë në mënyrë drastike. Është e pritshme që hyrjet nga kjo taksë do të stabilizohen në nivele mesatare në të ardhmen, ndonëse do të ishte mirë që këto të ardhura të përdreshin vërtet për investime në infrastrukturën vendore e jo si të ardhura me karakter të përgjithshëm për financimin e kostove korrente.

Tarifat vendore gjithashtu trajtohen në veçanti nga dokumenti si një burim i rëndësishëm i të ardhurave vendore. Vlen të përmendet se duhet të forcohet disiplina fiskale e njësisve vendore në drejtim të tarifave vendore dhe ndjekja e parimit që tarifa e shërbimit duhet të mbulojë kostot.

Të ardhurat e përbashkëta

SKNDQV diskuton problemin e mungesës së qëndrueshmërisë së politikave në lidhje me nivelin dhe administrimin e taksës së biznesit të vogël. Vlen të theksohet se ndryshimet në kuadrin fiskal kanë riformuluar dy taksa të reja të përbashkëta: taksën e biznesit të vogël dhe taksën e automjeteve. Ndarja e Tatimit për të Ardhurat Personale dhe Trajtimi Tarifor Favorizues diskutohen sërish në strategji, po pa ofruar ndonjë zgjidhje konkrete për mënyrën dhe përqindjen e ndarjes. Një studim për qeverinë shqiptare i mbështetur nga BB në vitin 2007²¹ mbi sistemin e taksave të përbashkëta e ka analizuar hollësisht potencialin e taksave të përbashkëta në sistemin shqiptar të transfertave ndërqeveritare, por ai nuk duket të jetë marrë asnjë herë parasysh nga aktorët politikë dhe artikulumit i temës mbetet në nivele teorike dhe të cekëta edhe në këtë draft.

Transfertat ndërqeveritare

Granti i pakushtëzuar dhe formula ekualizuese nuk janë diskutuar në këtë pamje të përgjithshme, e cila duket të ketë vënë theksin kryesisht në mangësitë e sistemit. Ndërkohë, sistemi i granteve të kushtëzuara dhe në veçanti grantet konkurruese (më vonë Fondi i Zhvillimit të Rajoneve) përshkruhet si një instrument me potencial për investimet vendore si edhe për bashkëfinancimin e projekteve më të mëdha me disa donatorë/financues.

Huamarrja vendore

Sipas strategjisë “Procesi i vërtetë i huamarrjes nga NjQV ka filluar në vitin 2009, por që atëherë të dhënat për kreditë e marra nga njësitë e qeverisjes vendore tregojnë se ato janë shumë të pakta dhe vlerësohen në 0.02% të stokut të borxhit kombëtar në vitin 2010 dhe në 0.04% në vitin 2013”. Në këtë dokument diskutohen kufizimet e vendosura nga Ministri i Financave për huamarrjen vendore në interes të ruajtjes së nivelit të borxhit kombëtar; por nuk përmendet mekanizimi/zgjidhja e sugjeruar nga MSHÇV për eliminimin e barrierave për huamarrjen vendore. Instrumente si Fondi Bashkiak i Investimeve apo PPP (që do të përkufizohej më mirë si koncesione vendore) përmenden vetëm shkarazi pa objektiva të qarta.

Metodologjia

Procesi i hartimit të strategjisë së decentralizimit

²¹ The Urban Institute (2007). *Intergovernmental transfers and shared taxes*.

Analizimi i procesit të hartimit të strategjisë mbështet në tre dimensione – transparenca, pjesëmarrja, dhe bashkëpunimi. Transparenca i referohet nivelit në të cilin qeveria siguron informacion që i lejon qytetarët t'i vendosin zyrtarët para përgjegjësisë; pjesëmarrja i referohet përfshirjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes me qëllim informimin, shkëmbimin e eksperiencave, dhe ndikimin e reformave qeveritare; dhe bashkëpunimi i referohet krijimit të urave të komunikimit me grupet e interesit dhe vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit për ta forcuar procesin e decentralizimit. Rëndësi i është kushtuar pasqyrit të procesit të hartimit të strategjisë në median e shkruar, vizive dhe hapësirës elektronike duke patur në vëmendje sasinë e informacionit të përcjellur publikut dhe grupeve të interesit për procesin dhe sa të hapura kanë qenë takimet e grupit dhe nëngrupeve të punës me median.

Matja e transparencës u fokusua në përmbajtjen e informacionit, cilësinë e informacionit, dhe metodat e komunikimit të informacionit. Disa nga pyetjet që u drejtuan gjatë analizës ishin si më poshtë: Çfarë metodash janë përdorur për të komunikuar strategjinë, p.sh. media e shkruar, media sociale? A është informacioni i dhënë i plotë, primarë, i aksesueshëm, i qartë, i shpejtë, dhe gjithëpërfshirës? Matja e nivelit të pjesëmarrjes u fokusua në grupet pjesëmarrëse dhe natyrën e pjesëmarrjes. Vëmendje e veçantë ju kushtua njërive vendore të përfshira në procesin e konsultimit. Matja e bashkëpunimit u fokusua në grupet e përfshira gjatë diskutimit të strategjisë dhe natyrën e bashkëpunimit. Disa nga pyetjet që u adresuan gjatë analizës ishin: A janë vendosur marrëdhënie bashkëpunimi gjatë procesit të konsultimit? Nëse po, me cilat grupe? Çfarë interesash përfaqësojnë ato? Analiza e përmbajtjes së dokumentave u realizua nga tre ekspertët e fushave të decentralizimit politik, administrativ, dhe financiar. Ekspertët u fokusuan në njësrë dokumentash, si draftet e strategjisë dhe raportet e grupeve të punës të përfshirë në hartimin e strategjisë.

Analiza e përmbajtjes së strategjisë së decentralizimit

Grupi i ekspertëve analizoi përmbajtjen e strategjisë së decentralizimit duke përdorur një përfaqëse krahasuese. U shqyrtuan ndryshimet që propozohen në strategjinë e re duke e krahasuar atë me dokumenta kombëtare dhe ndërkombëtare të tilla si Kushtetuta, Karta Evropiane, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, ligji organik, vendimet e Këshillit të Ministrave si dhe rekomandimet e Kongresit.

Shqyrtimi i perceptimeve të zyrtarëve rreth strategjisë së decentralizimit

Vëmendja u përqëndrua në mënyrën sesi e perceptojnë zyrtarët qendrorë dhe vendore strategjinë e decentralizimit. Për këtë, u përdor një kombinim i teknikave kërkimore sasore dhe cilësore. Pjesa sasore e studimit përfshiu dy (2) pyetësorë. Pyetësori i parë u përdor me qëllim grumbullimin e të dhënave nga zyrtarët vendorë, përkatësisht kryetarët/nën-kryetarët e bashkive/komunave, kryetarët e këshillit bashkiak/komunal dhe drejtuesit në fushën e financës ose shërbimeve, të shpërndarë në 12 qarqet e Shqipërisë. Pyetësori i dytë targetoi aktorët qendrorë, përkatësisht nëpunësit e ministrive të linjës, shoqatat e qeverisjes vendore, komunitetin e donatorëve dhe agjencive të ndryshme, shoqërinë civile relevante dhe deputetët e Kuvendit (anëtarë të Nënkomisionit për Qeverisjen Vendore).

Nga ana përmbajtësore, të dy pyetësorët përbëheshin nga gjashtë module: a)aksesi në informacion; b)njohuritë rreth strategjisë së decentralizimit; c)përmbajtja e strategjisë së decentralizimit; d)transparenca e qeverisë qendrore; e)pjesëmarrja në hartimin e strategjisë së decentralizimit dhe f)impakti i strategjisë së decentralizimit. Pyetësorët kishin respektivisht 11 pyetje me alternativa, 8 pyetje me alternativa po/jo, 2 pyetje me përzgjedhje të shumëfishtë dhe 2 pyetje të hapura.

Anketa e parë u realizua gjatë periudhës 21 nëntor 2014 – 8 janar 2015. Anketa e dytë u realizua përgjatë periudhës 17 dhjetor 2014 – 19 janar 2015. Ndërsa pyetësi i parë u shpërnda edhe në mënyrë të printuar dhe elektronike, pyetësi i dytë u shpërnda vetëm në mënyrë elektronike.

Pjesa cilësore e studimit pati si qëllim sigurimin e një informacioni më të hollësishëm lidhur me perceptimin rreth strategjisë duke u përqëndruar në tre dimensionet e decentralizimit: dimensionin politik, dimensionin administrativ dhe dimensionin financiar. Për këtë pjesë, gjashtë (6) fokus grupe u organizuan në të gjithë Shqipërinë ku u ftuan përfaqësues të qeverisjes vendore dhe shoqatave të zgjedhurve vendorë, institucioni i prefektit, përfaqësues të shoqërisë civile dhe agjencive ndërkombëtare dhe ekspertë të qeverisjes vendore. Fokus grupet u realizuan në periudhën kohore 4 – 19 dhjetor, 2014. Organizimi strukturor i fokus grupeve sipas qarqeve dhe numri përkatës i pjesëmarrësve ishte si më poshtë:

Nr.	Vendndodhja/Qarku	Dimension i diskutuar	Nr. i pjesëmarrësve
1	Kukës	Dimensioni Politik	12
2	Lezhë	Dimensioni Administrativ	6
3	Elbasan	Dimensioni Financiar	9
4	Durrës	Dimensioni Politik	8
5	Tiranë	Dimensioni Financiar	6
6	Fier	Dimensioni Administrativ	7

Analiza e të dhënave sasiore u përqëndrua tek kombinimi i elementeve të natyrës përshkruese dhe relacionale.²² Megjithatë, si rrjedhojë e kufizimit të të dhënave (e diskutuar më poshtë) dhe masës së vogël të kampionit që mbulonte aktorët qendrorë, analiza e anketës së dytë u fokusua ekskluzivisht tek tipari përshkrues. Ndërkaq, të dhënat cilësore të regjistruara në audio dhe të transkriptuara janë analizuar duke përdorur metodën e analizës së përmbajtjes.

Kampionimi i të dhënave sasiore

Kampioni përfundimtar²³ i pyetësorit të parë përbëhet prej 60 përfaqësuesish të zyrtarëve vendorë. Shpërndarja e kampionit sipas karakteristikave kryesore paraqitet në tabelën 1.

Tabela 1 Shpërndarja e kampionit sipas gjinisë, nivelit arsimor dhe pozicionit në qeverisjen vendore

Karakteristikat e kampionit	Frekuenca	Përqindje
-----------------------------	-----------	-----------

²²Të dhënat nga databaza e pyetësorit janë koduar, inputuar dhe përpunuar në programin statistikor STATA/SE 12.0.

²³Në këtë studim është përdorur kampionimi i qëllimshëm (konvenient).

Gjinia		
Burrë	45	75
Grua	15	25
Niveli arsimor		
I mesëm	2	3.33
I lartë	48	80
Master	10	16.67
	60	
Pozicioni		
Kryetar bashkie/komune	21	35
Nën-kryetar bashkia/komune	4	6.67
Kryetar i këshillit bashkiak/komunal	2	3.33
Drejtues në fushën e financës/shërbimeve	33	55
Total	60	100

Në total, popullata e kampionit përfshin 75% burra dhe 25% gra. Kjo shpërndarje gjinore prirret të reflektojë tipare të situatës reale të përfaqësimit të grave në qeverisjen vendore – pjesa dërrmuese e grave të anketuara është e punësuar si drejtuese dhe jo si e zgjedhur në njësitë përkatëse vendore. Përsa i përket shpërndarjes sipas nivelit arsimor, 80 % e kampionit raporton se ka arsim të lartë, 16.7% ka një diplomë pasuniversitare master dhe vetëm 3.3% është me arsim të mesëm. Ndërkohë, mosha mesatare e të anketuarve është 49 vjeç (± 9.1).²⁴ Tabela 1 raporton edhe shpërndarjen sipas pozicionit që të anketuarit kanë në qeverisjen vendore. Në kampion mbizotërojnë drejtuesit në fushën e financës/shërbimeve (55%) të ndjekur nga kryetarët e bashkive/komunave (21%). Mesatarisht, drejtuesit në fushën e financës/shërbimeve kanë një përvojë prej 10 vitesh në qeverisjen vendore. Intervali varion nga një minimum prej 1 viti deri në 22 vite përvojë. Përsa i përket të zgjedhurve vendorë, numri mesatar i mandateve në kampion është 2.

Në lidhje me mbulimin gjeografik pyetësori i aktorëve vendorë përfshiu të 12 qarqet e Shqipërisë. Informacioni mbi shpërndarjen gjeografike të kampionit është si më poshtë (shih tabelën 2).

Tabela 2 Shpërndarja gjeografike e kampionit

Pozicioni	Frekuenca	Përqindje
Berat	6	10
Dibër	5	8.33
Durrës	4	6.67
Elbasan	9	15
Fier	5	8.33

²⁴ 11 pjesëmarrës preferuan mos të përgjigjeshin pyetjes mbi moshën. Intervali i kampionit varionte nga mosha minimale 30 tek mosha maksimale 60.

Gjirokastrë	4	6.67
Korçë	2	3.33
Kukës	7	11.67
Lezhë	3	5
Shkodër	6	10
Tiranë	8	13.33
Vlorë	1	1.67
Total	60	100

Për të shqyrtuar nëse perceptimet e zyrtarëve mund të variojnë sipas ndarjes bashki-komunë në nivelin e parë të qeverisjes vendore dhe duke pasur parasysh që komunat do të suprimohen dhe do të konsiderohen njësi administrative përbërëse të bashkive sipas reformës administrativo- territoriale, u krijua ndryshorja që diferencon midis të dyjave.²⁵ Si rezultat, bashkitë përfaqësojnë 68% të kampionit, ndërsa komunat 32% (shiko tabela 3). Në të njëjtën linjë, për të hulumtuar nëse perceptimet e ndryshme mbi strategjinë mund të variojnë edhe sipas afinitetit politik që përfaqësojnë njësitë vendore, është krijuar ndryshorja që lidh emrin e njësisë prej pyetësorit të parë me të dhënat prej buletinit të KQZ rreth kandidatëve fitues në të gjitha njësitë vendore në Shqipëri në zgjedhjet vendore të 8 maj-it 2011.²⁶ Në këto zgjedhje Aleanca për Qytetarin u drejtua nga Partia Demokratike e Shqipërisë dhe përfaqësoi koalicionin e djathtë, ndërsa Aleanca për të Ardhmen u drejtua nga Partia Socialiste e Shqipërisë dhe përfaqësoi koalicionin e majtë.²⁷ Shpërndarja e kampionit sipas Aleancave fituese pjesëmarrëse është si më poshtë (tabela 3): rreth 54% e kampionit mund të konsiderohet me orientim politik të djathtë, krahasuar me rreth 46% të kampionit me orientim të majtë.

Tabela 3 Shpërndarja sipas njësite të nivelit të parë të qeverisjes vendore dhe Aleancës fituese në 2011

	Frekuenca	Përqindje
Bashki	38	67.86
Komuna	18	32.14
Aleanca fituese në 2011		
Aleanca për Qytetarin	30	53.57
Aleanca për të Ardhmën	26	46.43

²⁵Në krijimin e kësaj variable për 4 individë të kampionit nuk është e mundur të bëhet identifikimi i njësisë vendore që i përket për mungesë të dhënash. Si pasojë, në kryqëzimet ku përdoret kjo ndryshore baza është N=56.

²⁶Lista shteruese e kandidatëve fitues në zgjedhjet lokale të 2011 e përdorur për krijimin e ndryshores: http://ëëë2.ccc.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/Legjislacioni_2011/Vendime_2011/VENDIM%201229/Lidhja%201.pdf

²⁷Gjithashtu duhet përmendur se kjo ndryshore është krijuar si një *proxy* për të kapur afinitetin politik të aktorëve vendorë në studim, megjithatë kjo ndryshore paraqet kufizimet e veta pasi që në konstrukt ajo krijon ekuivalencë në afinitet politik midis të gjithë zyrtarëve të identifikuar në një njësi vendore të caktuar. Duke u bazuar në realitetin shqiptar dhe faktin se qëllimi kryesor këtu është ai eksplorativ, ndërtimi i kësaj variable është i justifikuar nga ana metodologjike.

Përsa lidhet me kampionin e dytë ai u përfaqësua nga 30 aktorë të nivelit qendor. Demografia e analizës së kampionit tregoi se kampioni i aktorëve qendrorë është më i ri, më i mirë-arsimuar dhe më i balancuar nga pikëpamja gjinore krahasuar me kampionin e zyrtarëve vendorë. Mosha mesatare e të anketuarve është 45 vjeç (± 10.4). Përsa i përket nivelit arsimor, 16 kanë kryer studime pasuniversitare të nivelit master, të ndjekur nga 8 të nivelit doktoraturë dhe 6 të anketuar me studime universitare. Ndërkohë, sipas gjinisë të anketuarit ndahen në 15 burra dhe 15 gra.

Rezultatet

Kapitulli i rezultateve do të ndahet në tre seksione: rezultatet e monitorimit të procesit të hartimit të strategjisë, analizës së strategjisë, dhe shqyrtimit të perceptimeve të aktorëve qendrorë, vendorë, dhe grupeve të tjera të interesuara.

Procesi i Hartimit të Strategjisë

Transparenca e procesit të hartimit të Strategjisë

Për matjen e nivelit të transparencës jemi fokusuar në sasinë e informacionit të komunikuar, cilësinë e tij (nëse informacioni i dhënë është i plotë, i aksesueshëm, i shpejtë dhe gjithëpërfshirës) dhe në metodat e ndjekura të komunikimit.

Aktet, afatet dhe publikimi.

Procesi i hartimit të SKNDQV filloi me daljen e Urdhërit të Kryeministri nr. 69, datë 13.2.2014, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e strategjisë ndërsektoriale të decentralizimit dhe qeverisjes vendore 2014-2020”. Udhëri përmban ngritjen, përbërjen, objektivin kryesor të grupit ndërinstitucional si dhe afatet e përfundimit të hartimit të strategjisë. Pika 8 e Urdhërit vendosi detyrimin që projekti i parë i strategjisë të hartohet brenda muajit korrik 2014. Në planin e veprimit të përbashkët (MSHÇV dhe Projektit të USAID), publikuar në 28 mars 2014 ishte parashikuar që në javën e parë të muajit korrik 2014 të përfundonte drafti final i strategjisë dhe në javën e fundit të muajit korrik 2014 të fillonte monitorimi i procesit të decentralizimit. Evidentohet se nuk u arrit të respektohen afatet për hartimin dhe miratimin e strategjisë për arsye të disa vështirësive objektive dhe të kompleksitetit që mbarte në këtë periudhë hartimi i një strategje të tillë.

Në muajin gusht u finalizua draft “Strategjia e Decentralizimit”, versioni gusht 2014; në muajin tetor versioni i dytë, versioni tetor 2014, dhe në muajin shkurt, versioni final shkurt 2015. Në tryezën e organizuar nga DLDP dhe PLGP/USAID në datë 23 tetor 2014 bëhet publike për herë të parë draft strategjia, versioni tetor 2014, për grupet e interesit. Draft-Strategjia e Decentralizimit dhe Plani i Veprimit u publikuan për herë të parë në 3 dhjetor 2014, në website-n e MSHÇV-së. Më vonë gjatë këtij muaji u publikua edhe versioni anglisht i dokumentit. Në muajin mars 2015, versioni final shkurt 2015, strategjia dhe plan veprimi u publikuan në faqen elektronike të MSHÇV-së në shqip dhe anglisht.

Takimet

U monitoruan disa takime të zhvilluar gjatë procesit të hartimit të strategjisë (i) takimi i grupit të punës në 28 mars 2014; (ii) takimet e tre shoqatave të të zgjedhurve vendore me mbështetjen e opozitës, të mbajtura në datë 24 qershor, 27 qershor dhe 2 korrik 2014; (iii) tryeza e rrumbullakët “Reforma Territoriale dhe Decentralizimi Fiskal” e organizuar nga MSHÇV në 12 shtator; (iv) tryeza e organizuar në 10 tetor 2014 nga MSHÇV për të diskutuar propozimet për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin organik; (v) tryeza e organizuar nga PLGP/USAID dhe DLDP në 23 tetor 2014, ku një nga çështjet objekt diskutimi në tryezë ishte “Strategjia e re e decentralizimit (draft versioni tetor)”; dhe (vi) takimet e nëngrupeve të punës.

Gjatë monitorimit evidentuam:

- a) Pjesëmarrësve u ishte dërguar më përpara, me rrugë elektronike, ftesa dhe programi i takimit i cili përmbante agjendën dhe objektivat që synonte të arrinte takimi. Në dosjen e çdo pjesëmarrësi ishin të vendosur prezantimet që do të mbaheshin dhe dokumenta të tjerë të lidhur me çështjen në diskutim. Organizatorët ishin të hapur për çdo pyetje dhe diskutim nga pjesëmarrësit.
- b) Takimet e grupit të punës dhe tryezat e organizuara për këtë qëllim ishin të hapura dhe u raportuan gjerësisht nga media e shkruar dhe audiovizive. Takimet u publikuan në websitin e MSHÇV, PLGP/USAID, DLDP etj.
- c) Takimet e nëngrupeve të punës, duke qenë diskutime teknike, kanë qenë të mbyllura.

Konsultimet

Në bazë të një plani, MSHÇV në bashkëpunim me PLGP/USAID organizoi procesin e konsultimit të strategjisë me përfaqësues të qeverisjes vendore dhe të organeve të dekoncetrura. U organizuan 4 takime konsultimesh dhe dy nga këto (Shkodër dhe Tiranë) u monitoruan nga IDM. Të dy takimet e monitoruara nga IDM ishin të mirëorganizuara, me ftesa të dërguara paraprakisht, me një prezantim të mirë përmbledhës të strategjisë nga ana e ekspertit PLGP/USAID, me pyetje, diskutime dhe përgjigje të shumta kryesisht për funksionet e përbashkëta. Metodologjia e ndjekur nga ana e ekspertit PLGP/USAID ishte mjaft e mirë, pjesëmarrësve ju dha hapësirë e mjaftueshme për të shprehur mendimet, pikëpamjet dhe sugjerimet e tyre. Takimet ishin të hapura për median, e cila e pasqyroj lajmin.

Debate Televizive dhe Artikuj e Shkruar

Tryezat e debatit në televizion dhe artikujt e shkruar janë një instrument i mirë për të përcjellë te publiku problematikat e qeverisjes vendore, sfidat që ndeshen, praktikat më të mira dhe çfarë do të bëhet në të ardhmen.

Gjatë monitorimit ne evidentuam:

- a) Një tryezë debati në median vizive me përfaqësues të MSHÇV-së dhe përfaqësues të shoqatave të autoriteve vendore.

- b) Një numër i vogël artikujsh dhe analizash të pasqyruara në median e shkruar, ku veçohen disa artikuj nga ekspertët të fushës dhe përfaqësues të grupeve të interesit.
- c) Ekspertët e angazhuar nga IDM për monitorimin e procesit të hartimit të Strategjisë kanë qenë të pranishmëm në median vizive (UTV News dhe A1 Report) për t'i përcjellë publikut gjetjet nga procesi i hartimit të strategjisë.

Dokumenta, raporte dhe studime në dispozicion të grupit të punës

Dokumentat, raportet dhe analizat që u vendosën në dispozicion të grupit të punës dhe nëngrupeve mbulojnë gjithë problematikat e qeverisjes vendore, sfidat me të cilat ajo ndeshet si dhe synimet për të ardhmen. Vlerësojmë se shfrytëzimi i këtyre dokumentave nga ekspertët dhe grupe interesi jashtë grupit të punës ka paraqitur vështirësi. Disa nga dokumentat, raportet dhe analizat nuk ishin pasqyruar në website. IDM gjykon se krijimi i një website që do të publikonte të gjithë këto dokumenta do të lehtësonte shfrytëzimin e tyre nga ekspertët të pavarur dhe aktorë dhe grupe interesi. Një qasje e tillë u zbatua për reformën territoriale-administrative.

Pjesëmarrja

Procesi i hartimit të Strategjisë së Decentralizimit ka ecur bazuar në një qasje, të logjikshme, nga lart poshtë. Afatet kohore ishin të ngushta dhe disi të sforcuara. Megjithatë pjesëmarrja vlerësohet pozitivisht.

Pjesëmarrja në grupin ndërinstitucional të punës konsiderohet gjithëpërfshirëse. Morën pjesë 41 institucione dhe organizma me përfaqësues nga ministrinë e linjës, njësitë e qeverisjes vendore, shoqatat e të zgjedhurve vendor, biznesi, shoqëria civile, organizata kombëtare dhe ndërkombëtare dhe donatorë që operojnë në Shqipëri. Edhe pse pjesë e grupit të punës, jo të gjithë shoqatat e të zgjedhurve vendor morën pjesë në takimet e grupit të punës.

Tre shoqatat e të zgjedhurve vendore (bashki, komuna, qarqe) organizuan tre konferenca (24 qershor, 27 qershor dhe 2 korrik 2014), që në thelb kishin decentralizimin dhe ndarjen territoriale-administrative. Në këto konferenca morën pjesë përfaqësues të partive opozitare. Në konferencën e datës 27 qershor, morën pjesë dhe përfaqësues të maxhorancës (Z.Bashkim Fino, bashkëkryetar i Komisionit të posaçëm parlamentar për reformën territoriale dhe Z. Petrit Vasili, kryetar i grupit parlamentar të LSI) si dhe përfaqësues të MSHÇV.

Ministri i SHÇV organizoi 2 tryeza të rumbullakëta me tematikë refromën territoriale dhe decentralizimi fiskal dhe disa ndryshime ne ligjin organik për qeverisjen vendore. Përfaqësuesit e opozitës dhe një pjesë e shoqatave të të zgjedhurve vendor nuk morën pjesë në këto tryeza edhe pse ishin ftuar paraprakisht.

MSHÇV organizoi 4 takime konsultative rajonale ku u ftuan përfaqësues nga të 12 qarqet e vendit. Në total morën pjesë 160 persona. Nga këto 78 persona përfaqësonin njësi të qeverisjes vendore dhe 82 persona përfaqësonin agjensi të dekoncentruara dhe aktorë të interesit. IDM monitoroi dy nga

ketë takime dhe përkatësisht takimin e Shkodrës dhe atë të Tiranës. Në takimin e Shkodrës morën pjesë 41 përfaqësues të organeve të dekoncentruara të qeverisjes qendrore, Prefekti dhe përfaqësues të tij, përfaqësues të mjedisit, shëndetësisë, arsimit, pasurive të paluajtshme dhe pyjeve. Përfaqësuesit e njësive të qeverisjes vendore ishin të paktë në numër. Mungonin përfaqësuesit e spektrit të djathtë. Në takimin e Tiranës kishte 19 drejtues dhe përfaqësues të 8 njësive të qeverisjes vendore, nga të cilët, vetëm 3 pjesëmarrës përfaqësonin njësi të djathta.

Bashkëpunimi

Bashkëpunimi i referohet krijimit besimit dhe urave të komunikimit me institucionet qeverisëse, grupet e interesit dhe me aktorë të tjerë me qëllim për të siguruar gjithëpërfshirje dhe për të pasur vlerë të shtuar në procesin e hartimit dhe zbatimit të decentralizimit.

Janë lehtësisht të evidetuara përpjekjet dhe angazhimet serioze të Ministrisë të Shtetit për Çështjet Vendore dhe të stafit të tij për të siguruar një bashkëpunim efektiv me ministrinë e linjës, donatorët, programet në fushën e qeverisjes vendore, institucionet e dekoncentruar, njësitë e qeverisjes vendore, shoqatat e të zgjedhurve vendor dhe shoqërinë civile.

Një vlerë të shtuar të bashkëpunimit MSHÇV dhe stafi i tij arritën të sigurojnë nëpërmjet programeve PLGP/USAID dhe DLDP të cilët në zonat e tyre arritën të krijojnë ura komunikimi dhe bashkëpunim efektiv me të zgjedhurit vendor, shoqërinë civile dhe ekspertë duke prodhuar sugjerime dhe rekomandime për përmirësimin e procesit të hartimit e të përmbajtjes së strategjisë së re.

Gjithashtu në gjatë procesit të hartimit të strategjisë evidentuam se:

- Bashkëpunimi ndërinstitucional në nivel qendror herë-herë shfaqti probleme që kishin të bënin më disa vonesa nga ministrinë e linjës për të dhënë kontributet e tyre në kohë gjatë procesit.
- Për shkak të mungesës së besimit mungoi bashkëpunimi mes faktorëve politikë (pozitë/opozitë) në procesin e hartimit të draft strategjisë. Sugjerohet gjetja e rrugëve dhe rritja e besimit reciprok me qëllim përfshirjen e gjithë faktorit politik në procesin e hartimit të strategjisë e për të siguruar cilësi dhe qëndrueshmëri të strategjisë.
- Bashkëpunimi me shoqatat e të zgjedhurve vendorë herë pas herë shfaqti probleme që vinin kryesisht nga faktorë politikë.
- Bashkëpunimi me shoqërinë civile ka qenë i mirë dhe gjithëpërfshirës.
- Bashkëpunimi me IDM, si organizatë e shoqërisë civile që po monitoronte procesin e hartimit të strategjisë ka qenë i mirë, i hapur dhe me kontribute të ndërsjella për të përmirësuar procesin dhe përmbajtjen e strategjisë.

Përmbajtja e Strategjisë

Përmbajtja e strategjisë u analizua sipas dimensionit politik, administrativ, dhe financiar. Më poshtë është një përmbjedhje e rezultateve të analizës.

Dimensioni politik

SKNDQV përkufizohet si një vizion, tërësi objektivash, prioritetesh dhe veprimesh që do të jenë në themel të veprimtarisë së qeverisë qendrore dhe qeverisë vendore për periudhën 2014-2020. Edhe pse miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM), ajo duhet kuptuar, hartuar dhe zbatuar si dokument qeverisës dhe jo si dokument i një qeverie të caktuar. Analiza e strategjisë vlerëson nëse janë adresuar si duhet problemet që kanë karakterizuar decentralizimin. Gjithashtu ajo do të shihet si proces dinamik ndryshimesh e përmirësimesh që vijnë si rezultat i punës së grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e strategjisë dhe si rezultat i përfshirjes në strategji të propozimeve dhe amendimeve të bërë nga grupe të interesit gjatë procesit të diskutimeve dhe konsultimeve.

Vetëqeverisja nëpërmjet përfaqësuesve dhe pjesëmarrjes qytetare

IDM përmes dokumentit të politikave Nr. 4 “Drejt De-Centralizimit? Një analizë e mjedisit mundësues për decentralizimin në Shqipëri” (shtator 2014) vendosi në vëmendje të anëtarëve të grupit të punës për hartimin e strategjisë së re, **çështjen e përfaqësimit gjinor** në këshillat vendor. U evidentua që në draft-strategji, versioni gusht 2014, çështja e përfaqësimit gjinor nuk trajtohej.

Draft-strategjia, versioni tetor 2014, bëri një hap pozitiv në këtë drejtim. Tek prioriteti 3 (Të forcojë qeverisjen e mirë në nivel vendor) citohet “Prioritet do të jetë edhe rritja e përfaqësimit të grave dhe vajzave në strukturat qeverisëse vendore në nivel përfaqësues dhe ekzekutiv”. Më tej, draft-strategjia, versioni shkurt 2015, ndërmoi një hap cilësor. Tek pjesa “Strukturat e qeverisjes vendore” përshkruhet synimi ambicioz “...rritja e përfaqësimit të të rinjve dhe grave në këshillat vendor me deri në 50% të përbërjes së këshillave”. Me nismën e një grupi deputetesh, ky synim u materializua me shtesën që iu bë pikës 6, të nenit 67, të Kodit Zgjedhor “Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, për çdo këshill bashkie, një në çdo dy emra të njëpasnjëshëm në renditje duhet t’i përkasë së njëjtës gjini”. Si rezultat i këtyre zhvillimeve, përfaqësimi gjinor në këshillat vendor ka marrë një dimension të ri shumë pozitiv.

Një tjetër çështje që ngriti IDM në dokumentin e politikave nr. 4 ishte **përfaqësimi në Këshill të Qarkut**. Në draft strategji version gusht 2014 tek objektivi strategjik “Rritja e efikasitetit të të gjithë strukturave të qeverisjes vendore” është parashikuar prioriteti “Rajonalizimi dhe reforma e qarqeve” i cili në thelb ...”do të synojë krijimin e rajoneve dhe rikonfigurimin e qarqeve sipas modeleve evropiane të rajoneve vetëqeverisëse” dhe kjo do të çojë “...në krijimin e një modeli të ri dhe më efikas organizimi dhe funksionimi të autoriteteve qendrore dhe vendore në nivel rajonal”. Në bazë të këtij prioriteti, rikonfigurimi do të kërkojë krahas aspekteve të tjera (të territorit, kompetencave dhe burimeve financiare) hapjen e diskutimit për mënyrën e zgjedhjes së këshillit të qarkut. Në draft strategjinë versionin tetor dhe në strategjinë versionin final shkurt 2015 prioriteti i sipërcituar nuk gjendet më. Çështja e përfaqësimit në këshill të qarkut u bë objekt diskutimesh gjatë procesit të

hartimit, konsultimit dhe miratimit të ligjit Nr 30/2015, datë 31.7.2000 i cili nëpërmjet nenit 17 ndryshoj pikat 1 dhe 2 të nenin 50 të ligjit organik. Në thelb këto ndryshime modifikuan numrin e përfaqësuesve në raport me numrin e popullsisë por pa prekur parimin, procedurën e zgjedhjes dhe pa zgjidhur pabarazinë në përfaqësim.

Të dhënat nga numri i popullsisë²⁸ tregojnë se 299,989 banorë të bashkisë Durrës do të përfaqësohen në Këshill të qarkut me 9 këshilltarë, ndërkohë 123,711 banorë të dy njërive të tjera (Shijak dhe Krujë) do të përfaqësohen me 9 këshilltarë. Mbi 200,000 banorë të bashkisë Shkodër do të përfaqësohen në këshill të qarkut me 8 këshilltarë, ndërkohë 131,371 banorë të 4 njërive të tjera do të përfaqësohen me 13 këshilltarë; (c) 59,393 banorë të bashkisë Kukës do të përfaqësohen në këshill të qarkut me 5 këshilltarë, ndërkohë 49,463 banorë të 2 njërive të tjera do të përfaqësohen me 8 këshilltarë; (d) 757,361 banorë të bashkisë Tiranë do të përfaqësohen në këshill të qarkut me 19 këshilltarë, ndërkohë 282,102 banorë (më shumë se dyfishi më pak) të 4 njërive të tjera do të përfaqësohen me 19 këshilltarë. Këto të dhëna tregojnë se nuk kemi shpërndarje të qartë e të balancuar të mandateve për këshillin e qarkut dhe as në përpjesëtim me popullsinë. Bashkitë me popullsi më të vogël përfaqësohen me më shumë këshilltarë dhe zotërojnë shumicën në vendimmarrje.

Zgjidhja që ka bërë ligji Nr 30/2015, datë 31.7.2000 përfaqësimin në këshillin e qarkut nuk është në një linjë me rekomandimet 201 (2006) dhe 349 (2013) të Kongresit si dhe as në përputhje me parimin “votim i barabartë”/fuqi e barabartë e votës.

Një tjetër çështje që ngriti IDM në dokumentin e politikave nr. 4 ishte **pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje**. IDM konstatoi se ligji organik rregullon, nëpërmjet nenit 35, vetëm dy nivelet e para të pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje (informimin dhe konsultimin), por nuk ka dispozita që rregullojnë dhe mbështesin pjesëmarrjen aktive qytetare (dialogun dhe partneritetin) dhe as dispozita që rregullojnë peticionin dhe iniciativën qytetare. Në draft-strategjinë, versionin gusht 2014, thuhet se për të arritur vizionin “do të rritet pjesëmarrja e qytetarëve dhe grupeve të interesit në procesin e vendimmarrjes së qeverisjes vendore”. Në versionin tetor 2014 të draft-strategjisë gjenden edhe tre detajime të tjera më pozitive. Tek objektivi “Të forcojë qeverisjen e mirë në nivel vendor” thuhet “Aktivizimi qytetar do të nxitet nëpërmjet fuqizimit të strukturave komunitare...”. Tek nënkapitulli 4.2 “Strukturat” thuhet “Përfaqësimi i qytetarëve dhe vendimmarrja efikase do duhet të mbështeten me kanale të reja të komunikimit midis të zgjedhurve dhe zgjedhësve duke respektuar në maksimum parimet e një demokracie funksionale dhe përfaqësuese në nivel vendor” dhe “synohet që këshillat të jenë forume të demokracisë lokale duke garantuar një lidhje më të fortë me strukturat komunitare dhe shoqërinë civile. Pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrjen e këshillave bashkiakë do të rritet nëpërmjet aktivizimit qytetar në politikën vendore”.

²⁸ Shiko: <http://gis.ceshtjetvendore.gov.al/>

Në draft-strategji, versioni shkurt 2015, gjejmë një aspekt tjetër pozitiv që lidhet me pjesëmarrjen qytetare në vendimarrje. Nënkapitulli “Strukturat komunitare” citon “Jeta komunitare dhe përfshirja e qytetarëve në punë e qeverisjes vendore do të rivitalizohen nëpërmjet krijimit dhe mbështetjes së strukturave komunitare në nivelin vendor”. Në planine veprimtarashikohet masa II.C “Programi i transparencës dhe pjesëmarrjes në vendimarrjen në nivel vendor”. Është për t’u theksuar miratimi i ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” i cili hyn në fuqi në fund të muajit maj 2015 dhe përcakton rregullat dhe procedurat e njoftimit e të konsultimit publik që zhvillohet nga organet publike në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse. Në mënyrë të përmbledhur ne konkludojmë se proceset e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje (informimi dhe konsultimi) i është kushtuar një rëndësi e veçantë. Këtë e evidentojmë në përmirësimet në përmbatje që ka pësuar kjo çështje gjatë procesit të hartimit të strategjisë si dhe me miratimin ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Problemi i **referendumeve vendore** u bë objekt diskutimesh nga shumë njësi të qeverisjes vendore dhe nga shoqatat e të zgjedhurve vendore gjatë procesit të reformës territoriale-administrative si një e drejtë e qytetarëve për t’u shprehur për ndryshimin e kufijve administrativ. Gjatë procesit të hartimit të strategjisë së decentralizimit nuk pati ndonjë analizë për referendumet vendore e për pasojë nuk ka ndonjë përshkrim apo masë në strategji dhe plan veprimin. Çështja e referendumeve vendore është mirë të shqyrtohet dhe të rregullohet me ligjin e ri për qeverisjen vendore dhe sipas praktikës më të mirë europiane duke i parë referendumet për çështje vendore si çështje në autoritet të këshillave bashkiakë.

Marrëdhëniet mes qeverisë qendrore dhe vendore

Në strategji marrëdhëniet ndërqeveritare janë trajtuar mirë. Në nënkapitullin 1.5, faqe 14, deklarohet se “Decentralizimi do të jetë i suksesshëm vetëm nëse autoritetet vendore do të mund të promovojnë me sukses interesat e tyre, duke u angazhuar në dialog politik me qeverinë qendrore dhe të bashkëpunojnë mes tyre”, gjithashtu në këtë nënkapitull (i) jepet mënyra se si do të përmisohen keto marrëdhënie “Marrëdhëniet ndërqeveritare do të përmirësohen nëpërmjet ngritjes së mekanizmave institucionale të dialogut si dhe miratimit të legjisllacionit përkatës në fushën e financave vendore” (ii) përcaktohet formalizimi me ligj i procesit të konsultimit “duhet të bëhen ndryshimet ligjore me qëllim formalizimin me ligj të procesit të konsultimit të autoriteteve qendrore me ato”. Në nënkapitullin 2.2 faqe 24 jepet angazhimi i qeverisë “Asnjë vendim që ndikon në qeverisjen vendore nuk do të merret pa u konsultuar më parë me përfaqësuesit e qeverisjes vendore”.

Plani i veprimit ka disa masa që adresojnë përmirësimin e marrëdhënieve mes qeverisë qendrore dhe vendore, ndër të cilat mund të përmendim (a) masën në pikën II-1.1/A “Programi i forcimit të bashkëpunimit qeveri qendrore-qeveri vendore. Ngritja e Këshillit Konsultativ dhe bashkëpunimi me shoqatat vendore” (b) masën në pikën II-II/A “Ngritja e grupit teknik të punës me përfaqësues vendorë e qendrorë për të shqyrtuar dhe identifikuar fushat specifike të kuadrit aktual ligjor që ka nevojë të ndryshohet” (c) masën në pikën pikën II.3/b “Krijimi i dialogut mes aktorëve kryesorë nga

organizatat qendrore, vendore dhe financiare për të shqyrtuar kuadrin ekzistues ligjor dhe për të evidentuar përfaqset e reja ndaj huamarrjes”.

IDM nëpërmjet dokumentit të politikave Nr.5 (nëntor 2014) e vlerësoi si hap pozitiv përfshirjen e konsultimit në draft ligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.8652”, datë 31.7.2000, por evidentoi edhe disa problematika të brendshme. Ato linden prej: (i) përkufizimit të konsultimit; (ii) mënyrës evazive të konsultimit; dhe (iii) vendosjes së Këshillit të Ministrave si autoritetin që përcakton strukturën, formën, mënyrën e organizimit, funksionimin, natyrën e çështjeve për konsultim dhe frekuencën kohore të procesit të konsultimeve (neni 5 i draft ligjit). Mbi këtë bazë kanë lindur dyshimet se **qeveria ruan kontrollin mbi konsultimin**. Ligji i ri që po hartohet pritet t’i japë zgjidhje të mirë dhe përfundimtare kësaj çështje.

Qarqet një “fushë e paplotësuar”

Analiza e strategjisë të decentralizimit është parë në prizmin se “sa dhe si” i adreson problemet e evidentuara në kornizën ligjore “**qarku fushë e paplotësuar**” dhe në raport me shqetësimet dhe rekomandimet e Kongresit për qarqet. Evidentojmë disa evoluime pozitive nga versioni i parë tek version final i SKNDQV, por edhe disa pasaktësi dhe evoluime jo pozitive, bazuar në faktet e mëposhtme:

Në draft strategjinë, version gusht 2014, në faqen 12, “Ligji organik parashikon **Qarkun** me rolin e tij bashkërendues në harmonizimin e politikave kombëtare me ato vendore dhe rajonale. Ndikimi i zhvillimit social-ekonomik në nivel rajonal, dhe roli i qarkut kanë qenë të dobëta për shkak të mungesës së një modeli të qartë për funksionimin e qarkut, mungesës së burimeve financiare, aseteve dhe kapacitetit të ulët institucional. Strategjia për zhvillim rajonal u hartua në vitin 2008, e ndjekur nga Projektligji për zhvillimin rajonal. Ndërkohë strategjia u miratua, projekt-ligji nuk arrit të miratohej”. Ky paragraf evidenton qartësisht problematikën për qarqet, por përmban disa pasaktësi kushtetuese dhe ligjore sepse qarku me kushtetutë dhe me ligj nuk ka rolin e “bashkërenduesit” por atë të “ndërtimit dhe zbatimit të politikave rajonale”²⁹.

Në draft strategjinë, version tetor 2014, në faqen 11 dhe në versionin final, faqe 12 paragrafi i sipërcituar ka pësuar disa ndryshime. Në sensin jo pozitiv janë hequr dy fjali: “Strategjia për zhvillim rajonal u hartua në vitin 2008, e ndjekur nga Projektligji për zhvillimin rajonal. Ndërkohë strategjia u miratua, projekt-ligji nuk arrit të miratohej”. Këto dy fjali nuk kishin pse të hiqeshin sepse ato mbartin përpjekjen e parë dhe serioze për t’i dhënë qarqeve udhërefyesin se si do ta ushtronin funksionin e vetëm kushtetues dhe ligjor që kanë. Në sensin pozitiv, janë shtuar dy fjali të tjera: “Politikat në drejtim të zhvillimit rajonal dhe rajonalizimit do mund të japin qarkut një rol të ri në të ardhmen. Megjithatë këto politika duhet të harmonizohen me rekomandimet e Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian përsa i përket strukturës së Qarkut si njësi e qeverisjes vendore”. Fjalitë e shtuara mbartin pak a shumë strukturën, rolin dhe marrjen e përgjegjësisë së zhvillimit rajonal nga ana e qarkut sipas rekomandimet e KiE dhe BE.

²⁹Neni 110, pika 2 e Kushtetutës dhe Neni 13, pika 1 e ligjit organik

Në strategji (version final Shkurt 2015) në faqen 12 shtohen edhe paragrafët “Me ndarjen e re, qarqet kanë në përbërjen e tyre mesatarisht 5 bashki nga 31 njësi vendore që kishin më parë me ndarjen e vjetër. Në këtë kontekst, Qarku me rolin e tij bashkërendues në harmonizimin e politikave kombëtare me ato vendore dhe rajonale bëhet më i lehtë dhe më eficient”, është e vertetë se puna e qarkut do të bëhet më e lehtë dhe më efiçente por roli i qarkut me kushtetutë nuk është “bashkërendues”.

Në draft strategjinë (version gusht 2014) në objektivin: Rritja e efikasitetit të të gjithë strukturave të qeverisjes vendore, faqe 17, gjejmë prioritetin “Rajonalizimi dhe reforma e qarqeve. Do të kryhet një reformim i veçantë i nivelit të dytë të qeverisjes vendore. Kjo reformë do të synojë krijimin e rajoneve dhe rikonfigurimin e qarqeve sipas modeleve evropiane të rajoneve vetëqeverisëse. Kjo reformë do t’u japë një drejtim të ri politikave kombëtare dhe rajonale të zhvillimit, duke çuar në krijimin e një modeli të ri dhe më efikas organizimi dhe funksionimi të autoriteteve qendrore dhe vendore në nivel rajonal”. ky prioritet në mënyrën se si është formuluar adreson më së miri problemet e qarqeve të përshkruara më sipër, por **ky prioritet nuk gjendet** në draft strategjinë ,version tetor 2014, dhe as në strategjinë ,version final shkurt 2015.

Në planin e veprimit gjejmë dy masa (III.1/B dhe IV.3/Ç) që kanë të bëjnë me “Rishikimi i funksioneve dhe kompetencave të Qarqeve” dhe me analizimin e funksioneve të përbashkëta pas ndarjes së re administrative e me matricën e kompetencave për tri nivelet qeverisëse.

Për sa cituam më sipër në strategjinë e decentralizimit në gjejmë një përpjekje serioze për të adresuar problemet e qarkut në zhvillimin rajonal dhe sipas rekomandimeve të KiE dhe BE. Por duhet të theksojmë se roli i qarkut me kushtetutë nuk është “bashkërendues” apo “koordinues”, por “Qarku është njësi ku ndërtohen e zbatohen politikat rajonale dhe ku ato harmonizohen me politikën shtetërore³⁰” prandaj këto terma duhen riparë sipas frymës së kushtetutës

Reforma administrativo-territoriale, nivelet e qeverisjes vendore, strukturat dhe kapacitetet

Në gjysmën e parë të vitit 2014 Shqipëria u përfshi në procesin e diskutimit dhe të miratimit të reformës administrativo-territoriale, e cila kishte tre objektiva kryesorë: (1) Përmirësimi i shërbimeve për qytetarët në nivel vendor; (2) rritja e efiçencës dhe mirëqeverisjes në nivel vendor; (3) fuqizimi i qeverisjes vendore, qytetarëve dhe komuniteteve.

Faza e parë e kësaj reforme u finalizua me miratimin e ligjit Nr. 115/2014, datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive vendore në Republikën e Shqipërisë” duke i lënë vend fazës së dytë, e cila përfshin dy periudha: (i) periudhën përgatitore ose tranzitore deri në qershor 2015 dhe (ii) periudhën implemtuese që fillon me konstituimin e bashkive të reja. Ligji i sipër cituar ka prodhuar dy efekte. Së pari, i jep vendit një sistem të konsoliduar territorial me 61 bashki dhe së

³⁰Neni 110 pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

dyti, suprimohet termi “komunë” – në ndarjen administrativo-territoriale, komunat aktuale si njësi të qeverisjes vendore kalojnë njësi administrative në përbërje të bashkive të reja.

Në versionin gusht 2014 të draft-strategjisë, në objektivin “Rritja e efikasitetit të të gjithë strukturave të qeverisjes vendore” përshkruhet prioriteti “Reforma administrativo-territoriale”. Aty thuhet “Reforma dhe zbatimi i ndarjes administrativo-territoriale, do të jetë prioriteti kryesor i strategjisë, e cila synon konsolidimin territorial të njësive vendore të nivelit të parë dhe nivelit të dytë. Reforma do zbatohet në përputhje me praktikën më të mira të reformave të tilla që janë zbatuar në vende të BE dhe bazuar në një proces gjithëpërfshirës”. Në versionin e tetor 2014 gjejmë disa zhvillime pozitive. Në kapitullin 4 “Politikat, objektivat dhe masat për zbatimin e strategjisë së decentralizimit”, gjejmë nënkaptullin 4.1 “Reforma administrativo-territoriale”, i cili nuk është tek version i gushtit. Ky aspekt vlerësohet pozitivisht pasi qartëson hapat që do të ndërmerren në dy periudhat e fazës së dytë të reformës administrativo-territoriale. Aty përcaktohen dy objektiva specifike të strategjisë

- i. Konsolidimi administrativ dhe financiar i 61 bashkive të reja pas miratimit të ligjit të ri për ndarjen administrativo-territoriale
- ii. Mbështetja institucionale dhe infrastrukturore për 61 bashkitë e reja pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015.

Një tjetër hap pozitiv vërehet në versionin shkurt 2015 të draft-strategjisë decentralizimit ku parashikohet krijimi i “Agjencisë së Zbatimit të Reformës Territoriale” me qëllim mbështetjen e njësive të reja të qeverisjes vendore deri në garantimin e funksionalitetit të plotë të tyre dhe me rol bashkërendues dhe koordinues midis institucioneve qendrore dhe njësive të qeverisjes vendore.

Versioni gusht 2014 i draft-strategjisë së decentralizimit, në prioritetin “Reforma administrativo-territoriale”, objektivi “Rritja e efikasitetit të të gjithë strukturave të qeverisjes vendore” thuhet “Reforma dhe zbatimi i ndarjes administrativo-territoriale, do të jetë prioriteti kryesor i strategjisë...”. Ndërkohë në versionet tetor 2014 dhe shkurt 2015 të draft-strategjisë e gjejmë të ndryshuar këtë formulim si më poshtë “Prioriteti kryesor i qeverisë është rishikimi i ndarjes administrativo-territoriale”. Mendojmë se përshkrimi në versionin gusht 2014 të draft-strategjinë është më i mirë dhe më i plotë sepse ne kemi të bëjmë me *reformë* administrativo-territoriale dhe me zbatim të saj dhe nuk kemi thjesht një rishikim të ndarjes administrativo-territoriale.

Në versionin përfundimtar të planit të veprimit ka një përmirësim rrënjësor në krahasim me versionin e tetorit. Nga dy masa që kishte në versionin e tetorit 2014, sot kemi një kapitull “I. Reforma Administrativo-Territoriale” dhe 10 masa që përfshijnë të gjithë elementët e zbatimit të reformës territoriale.

Si konkluzion, **strategjia e re ka përshkruar mirë dhe ka përcaktuar qartë objektivat dhe masat që do të ndërmerren për reformën administrativo-territoriale dhe zbatimin e saj.**

Nevojitet rishikimi i formulimit “rishikim të ndarjes administrativo-territoriale”.

Strukturat

Reforma administrativo-territoriale imponon një rishikim të plotë të strukturave të qeverisjes vendore. Në versionin gusht 2014 të draft-strategjisë nënkaptulli 4.1 “Strukturat”, përshkruan në linja të përgjithshme strukturat, i cili ka nevojë për plotësime të mëtejshme.

Ky nënkaptull ka pësuar plotësime dhe ndryshime pozitive në versionet tetor 2014 dhe shkurt 2015 të draft-strategjisë. Nënkaptulli 4.2 “Strukturat” në versionin tetor 2014, ndryshuar si Nënkaptulli 2.2 “Strukturat e qeverisjes vendore” në versionin shkurt 2015 përshkruhet mirë qëllimi kryesor i strategjisë: “konsolidimi i autonomisë vendore nëpërmjet mbështetjes për funksionimin me efikasitet të strukturave përfaqësuese, ekzekutive dhe komunitare të qeverisjes vendore në të gjitha nivelet” me pesë objektiva specifike. Synohet (a) fuqizimi i rolit të kryetarit në drejtëm të miratimit të strukturave organizative dhe të emërimit të drejtuesve të njësive administrative; (b) ruajtja e nivelit aktual të aksesit të qytetarëve në shërbimet nëpërmjet krijimit të njësive administrative përbërëse (ish-komunat) si pjesë funksionale e bashkive të reja”.

Për të realizuar këtë synim, Ministri i SHÇV përgatiti draft ligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8652, Datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore””, të cilin e paraqiti për konsultim në datën 10 tetor 2014 me shoqatat e të zgjedhurve vendor dhe organizatat partnere. IDM evidentoi disa problematika në këtë draft ligj të cilat i prezantoi në dokumentin e politikave Nr. 4 (shtator 2014) “Një vështrim analitik mbi Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8652 datë 31.07.2000””. Shtesat që parashikohen të bëhen nëpërmjet neneve 4, 10 dhe 13 të draft ligjit kanë të bëjnë me përbërjen e bashkisë nga disa njësi administrative, me emërimin dhe shkarkimin e administratorëve të njësive administrative si dhe me administratën e bashkisë në njësitë administrative. Ne evidetojmë se i) sipas nenit 113 të Kushtetutës, “këshillat komunal/bashkiak rregullojnë dhe administrojnë në mënyrë të pavarur çështjet vendore brenda juridiksionit të tyre” ii) sipas nenit 6 të Kartës Evropiane “bashkësitë vendore mund të përcaktojnë vetë strukturat e brendshme administrative” iii) ligji organik përcakton që komunat dhe bashkitë kanë kompetenca të plota administrative, shërbimi, investimi dhe rregullatore për funksionet e veta si edhe kanë të drejtë të krijojnë struktura administrative për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tyre.

Në mënyrë të qartë, Neni 8 i ligjit organik i njeh të drejtën njësive të qeverisjes vendore të “krijojnë nëndarje administrativo-territoriale brenda juridiksionit për rritjen e efikasitetit në kryerjen e funksioneve të tyre qeverisëse”. Ndryshimet që parashikohen të bëhen nëpërmjet neneve 4, 10 dhe 13 të draft ligjit “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin Nr 8652, datë 31.07.200...” nuk janë në frymën e dispozitave të sipërcituara sepse bashkive u hiqet e drejta (i) për të rregulluar dhe administruar në mënyrë të pavarur çështjet vendore brenda juridiksionit të tyre si dhe (ii) për të krijuar nëndarje administrativo-territoriale brenda juridiksionit që synojnë rritjen e efikasitetit. Ngritja e njësive administrative-territoriale jo në bazë të nevojave reale vendore dhe jo me synimin e rritjes së efikasitetit por të diktuar nga lart shton kostot financiare administrative të panevojshme për njësitë vendore dhe heq argumentin më të fortë të mbështetësve të sistemit të konsolidimit territorial, argumentin e kursimit të fondeve

Në draft ligjin e miratuar nga Këshilli i Ministrave më 26 nëntor 2014 si dhe në ligjin Nr. 30/2015, datë 2.4.2015 të miratuar nga kuvendi konstatojmë se një pjesë e rekomandimeve tona të publikuara

në dokumentin e politikave Nr.4 janë marrë në konsideratë. Neni 21 përcakton: “Deri në datën 31 dhjetor 2017, në çdo njësi administrative funksionon administrata e njësisë administrative. Nga 1 janari 2018, këshilli i bashkisë ka kompetencën të vendosë për riorganizimin e administratave të njësisë administrative, të cilat mund të mbulojnë territorin e një ose më shumë njësisë administrative brenda bashkisë, sipas nevojave të komuniteteve vendore dhe efektshmërisë administrative”.

Si konkluzion, strategjia e repërshkruan mirë qëllimin, objektivat specifike dhe masat për strukturat përfaqësuese, ekzekutive dhe komunitare. Pas 31 dhjetor 2017, bashkitë e reja marrin kompetencën e plotë të riorganizimit administrativ sipas nevojave të komuniteteve vendore dhe efektshmërisë administrative dhe kjo shkon në përputhje me nenin 113 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Kartës Evropiane.

Kapacitetet

Aftësia e njësisë të qeverisjes vendore lidhet me kapacitetet njerëzore, financiare dhe infrastrukturën administrative. Njësitë e vogla vendore përballen vazhdimisht me vështirësi për të ngritur kapacitetet njerëzore dhe financiare. Ky është përdorur si argument dhe pengesë për decentralizimin e plotë të kompetencave, përgjegjësisë dhe burimeve. Në versionin tetor 2014 të draft-strategjisë thuhet “Prania e shumë njësisë të vogla ka ndikuar në cilësinë e shërbimeve vendore për shkak të mungesës së kapaciteteve për të siguruar shërbimet me efikasitet të lartë”. Me miratimin e ligjit Nr. 115/2014, datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisë vendore në Republikën e Shqipërisë” ky argument bie sepse Shqipëria tashmë kalon në sistemin e konsoliduar territorial. Një nga efektet e mundshme pozitive të këtij sistemi ka të bëjë me faktin se “Njësitë e mëdha vendore mund të tërheqin staf me kualifikim e me aftësi më të mirë dhe e mbështesin këtë staf me paisjet teknike më të mira³¹” dhe do të kenë cilësi më të mirë në këshillat vendor.

Në shqyrtimin e draft-strategjisë, versioni shkurt 2015, në lidhje me kapacitetet dhe aftësitë administrative veçojmë sa më poshtë:

- i. I kushtohet një vëmendje e veçantë këtij aspekti “Reforma administrativo-territoriale do të kërkojë struktura të afta menaxheriale në bashkitë e reja. Prioritet do të jetë mbështetja për mirëfunksionimin e strukturave të zgjedhura (kryetarë bashkish dhe këshilltarë të bashkive) si dhe administratorëve lokalë si strukturë e re që do të krijohet”.
- ii. Në objektivin “Të forcojë qeverisjen e mirë në nivel vendor” paraqitet si prioritet “Fuqizimi i administratës vendore”. Aty theksohet se “Ajo do të jetë e gatshme t’i përgjigjet pritshmërive të komuniteteve dhe biznesit për shërbime publike, e aftë që të përballojë sfidat e integritetit evropian të vendit dhe thithjen e fondeve të BE.”
- iii. Në kapitullin “Politikat, objektivat dhe masat për zbatimin e strategjisë së decentralizimit”, nënkapitulli “Strukturat” detajohen politikat për fuqizimin e aftësive të qeverisjes vendore

³¹ Swianiewicz, P. *Is territorial consolidation – a necessary pre-condition for further decentralization?*

me theks të veçantë tetë zgjedhurit vendor (këshilli, kryetari) dhe administratën në njësitë administrative;

- iv. Rreth 30% e masave të parashikuara në planin veprimt lidhen me konsolidimin e kapaciteteve tËnjësive të qeverisjes vendore. Ky numër kaq i madh i masave në planin e veprimit shpjegohet me faktin se aftësia e njësive vendore deri më sot për të kryer detyrat vetëqeverisese ka lënë për të dëshiruar. Gjithashtu sistemi i konsoliduar territorial kërkon aftësi, kapacitete dhe infrastrukturë administrative shumë më të mirë. Që në fillim **grupi i punës duke parë rëndësinë e këtij komponenti ngriti nëngrupin tematik “Strukturat dhe marrëdhëniet ndërinstucionale”, i cili ka bërë një punë shumë të mirë.**

Defiçiti demokratik në kontekstin e sistemit të konsoliduar territorial

Strategjia, versioni final shkurt 2015, nuk është shprehur për efektet potencialisht negative të sistemit të konsoliduar territorial, por ajo në mënyrë të drejtëpërdrejtë me objektivat, prioritetet dhe masat minimizon në mënyrën më të mirë efektet potencialisht negative.

Në strategji citohet se për të arritur vizionin e strategjisë, qeveria “... do të rrisë transparencën dhe përgjegjshmërinë e qeverisë vendore ndaj komunitetit; ... do të rrisë pjesëmarrjen e qytetarëve dhe grupeve të interesit në procesin e vendimmarrjes së qeverisjes vendore”. Objektivi strategjik “Të forcojë qeverisjen e mirë në nivel vendor”, detajon 5 objektiva specifike/prioritete. Disa prej të cilave janë të lidhur ngushtë dhe ndikojnë në minimizimin e defiçitit demokratik si forcimi i transparencës dhe pjesëmarrja e grupeve të interesit në vendimmarrje, fuqizimii strukturave komunitare dhe fuqizimii administratës vendore. Një efekt shumë pozitiv në këtë drejtim sjell nënkapitulli 2.2 “Strukturat” në të cilin përfshin “Strukturat komunitare”. Strukturat komunitare vlerësohen si të dobishme dhe me rëndësi për përmirësimin e demokracisë vendore, minimizimin e efekteve potencialisht negative të sistemit të konsoliduar territorial, plotësimin e nevojave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.

Në plan veprim deri tani konstatojmë:

- i. dy masa të lidhura drejtëpërsëdrejti me minimizimin e efekteve potencialisht negative të sistemit të konsoliduar territorial dhe që janë (a) masa në pikën pikën II-1.1/C “Programi i Transparencës dhe Pjesëmarrjes në vendimmarrjen në nivel vendor” dhe (b) masa në pikën pikën II-1.1/D “Fuqizimi i strukturave komunitare në nivel vendor (kryetaret e fshatrave, ndërlidhësit qytetar”;
- ii. dy masa të tjera që ndikojnë indirekt në minimizimin e defiçitit demokratik: (a) masa në pikën pikën I/DH “Hartimi i statuteve dhe rregulloreve model të 61 bashkive të reja”. Në e shohin këte masë në aspektin e normimit të parimeve të qeverisjes së mirë dhe të përcaktimit të instrumentave dhe strukturave vendore për implementimin e tyre; (b) masa në pikën pikën II-1.1/A “Programi i trajnimit të këshilltarëve të rinj të 12 qarqeve dhe 61 bashkive”. Në e shohim këte masë në aspektin që në modulën e trainimeve do të përfshihen edhe kanalet e

komunikimit dhe të pjesëmarrjes së qytetarit në vendimarrje, të transparencës dhe të llogaridhënies.

Kompetencat dhe adresimi i tyre për zgjidhje

Strategjia ka një adresim të mirë të evidencave dhe rekomandimeve në lidhje me kompetencat e NjQV-ve për kryerjen e funksioneve që konsiderohen të përbashkëta. Në versionin final të draft-strategjisë, në kapitullin “Pamje e përgjithshme e qeverisjes vendore në Shqipëri”, përkthehen mirë problemet në lidhje me kompetencat në kryerjen e funksioneve që konsiderohen të përbashkëta. Këtu gjejmë mbi 5 paragrafë përshkruese nga të cilët veçojmë: “Në nivelin e funksioneve dhe kompetencave të përbashkëta ka akoma paqartësi që buron kryesisht nga mangësitë dhe paqartësia e vetë kuadrin ligjor që rregullon strukturën, rolet dhe kompetencat e autoriteteve qendrore e vendore në nivel rajonal dhe lokal”.

Nga tre prioritetet të përcaktuara tek objektivi strategjik “Të rrisë efikasitetin në tërësi të strukturave të qeverisjes vendore”, dy janë të lidhura ngushtësisht me rishikimin e kompetencave në funksionet e përbashkëta. Kapitulli 2 “Politikat, objektivat dhe masat për zbatimin e strategjisë së decentralizimit”, nënkaptulli 2.2.1 “Strukturat e dekoncentruara” përcakton disa synime që kanë të bëjnë me rishikimin e legjislacionit aktual të funksioneve dhe kompetencave të njësisë të dekoncentruara (arsim, shëndetësi, rendin publik, sistemin e kujdesit social, turizëm, etj.) në mënyrë që të identifikohen fushat ku ka mbivendosje ose përplasje të kompetencave dhe të hartohet matricat e kompetencave për çdo sektor. Ndërsa nënkaptulli 2.4.2 “Funksionet e përbashkëta” përcakton si prioritet “Të eliminohet mbivendosja e kompetencave ndërmjet strukturave të dekoncentruara në nivel vendor dhe strukturave të qeverisjes vendore”. Në planin veprimi, nënkaptulli IV.3 thuhet “Eliminohet mbivendosja e kompetencave ndërmjet strukturave të dekoncentruara në nivel vendor dhe strukturave të qeverisjes vendore”. Përcaktohen 5 masa të cilat janë të lidhura me kompetencat në funksionet e përbashkëta ku më të rëndësishmet janë (i) Rishikimi i Ligjit për Prefektin me qëllim qartësimin e statusit dhe rolit të prefektit për të shmangur mbivendosjet dhe (ii) Matrica e kompetencave për tri nivelet që përcaktojnë rolin e ministrive të linjes, institucioneve qendrore, institucioneve rajonale dhe NjQV-ve.

Në strategji nuk del qartë nëse qeverisja vendore do të ketë liri dhe kompetenca të plota për funksionet e veta/ çështjet vendore brenda juridiksionit të saj apo jo. Strategjia nuk i shmanget dot konfuzionit të krijuar nga terminologjia kompetenca “të veta” dhe “të deleguara” dhe funksione “të veta” dhe “të deleguara”, konfuzioni shtohet më tepër kur në strategji, faqe 7, gjejmë dhe termin “kompetenca të përbashkëta”.

Në konkluzion, strategjia përcakton disa synime ambicioze në fushën e kompetencave, në lidhje me funksionet e përbashkëta. Këto synime lidhen me qartësimin, rishikimin, harmonizimin dhe eliminimin e *mbivendosjes së kompetencave*

Dimensioni Administrativ

Parimet e decentralizimit, format dhe llojet e funksioneve

Transferimi i një funksioni nga niveli qendror në atë vendor, ka në themel parimin e subsidiaritetit ose afrimin e shërbimeve në nivelin më të ulët të shtetit, sa më afër qytetarëve. Karta Evropiane e Autonomisë Vendore e Këshillit të Evropës (Karta Evropiane), në nenin 4/3 përcakton “Funksionet publike përgjithësisht ushtrohen..., nga ato autoritete që janë më afër qytetarëve...”

Preferenca për caktimin e një kompetence të përgjithshme do t’i jepet autoritetit që është më afër shtetasve”. Ky është edhe thelbi i decentralizimit. E drejta e vetë-ushtrimit të funksioneve të transferuara gjen mbështetjen në autoritetin ligjor të organeve të qeverisjes vendore për të administruar veprimtarinë për realizimin e angazhimeve, në mënyrën më efektive në kushtet e njësisë përkatëse brenda rregullave dhe mënyrave të përcaktuara me ligj.

SKNDQV, versionishkurt 2015, ka tendencë për t’u mbështetur në këtë parim. Ka përpjekje për të tranferuar edhe funksione të reja drejt qeverisjes vendore, e lidhur kjo edhe me ndarjen e re territoriale. **Nuk ka shumë qartësi se si do t’i jepen funksionetqeverisjes vendore, nëse ato domosdoshmërisht do të shoqërohen me kompetenca të plota ekzekutive që do të thotë autoritet i plotë dhe i qartësuar ligjor i NjQV-ve, së bashku me mbështetjen e duhur financiare.** Sjellim në vëmendje faktin se edhe në kohë të mëparshme një pjesë e funksioneve, edhe pse janë të cituara në ligj, gjatë viteve 2000 nuk kanë gjetur zbatim ngaNjQV-të.

Në strategjinë aktuale citohet “parimi i decentralizimit asimetric bazuar në parimin e subsidiaritetit” dhe se “ato njësi vendore që kanë kapacitete njerëzore dhe burime financiare mund të kërkojnë decentralizimin e kompetencave të caktuara brenda funksioneve të përbashkëta apo dhe funksioneve të tjera që ushtrohen nga organet e qeverisë qendrore duke synuar ofrimin e shërbimeve në një standard më të lartë”. Kjo ofertë për bashkitë e ardhshme, lë hapësirë diskutimi në dy drejtime.

Së pari, ndarja e re territoriale pati një nga qëllimet e saj kryesore vendosjen e simetrisë funksionale nëpërmjet zonave funksionale. Presupozohet se ato do të jenë të tilla dhe si rrjedhojë, hipotetikusht asimetria nuk duhet të ekzistojë.

Së dyti, në rast se decentralizimi i kompetencave do të realizohet edhe në bazë të kërkesave jo të unifikuara, pa kryer paraprakisht analizat përkatëse që vërtetojnë drejtësinë e saktësinë e kërkesës sëtyre, atëherë do të krijojmë vetë një zhvillim asimetric të pa kontrolluar.

Duke konsideruar zhvillimin asimetric si një realitet të padiskutueshëm në bashkitë e ardhshme atëherë strategjia duhet të vendosë theksin për objektiva që favorizojnë rastin e kundërt kur njësi të caktuara nuk kanë kapacitetet e duhura për kryerjen e funksioneve. Bashkëpunimi ndërvendor dhe delegimi në qark bazuar në vullnetin e mirë të palëve, zgjidhje të hedhura për zbatim kohë më parë, kanë treguar se nuk kanë patur suksesin e duhur.

Decentralizimi administrativ përfshin transferimin e autoritetit, përgjegjësi dhe burimeve vendimmarrëse për kalimin e shërbimeve publike nga qeverisja qendrore drejt niveleve më të ulëta qeverisëse, duke ardhur sa më pranë qytetarëve e njëkohësisht duke rritur kështu përgjegjësinë e qeverisjes vendore dhe të vetë qytetarëve të përfshirë në proces. Procesi i kalimit të një grupi të caktuar të shërbimeve nga pushteti qendror drejt qeverisjes vendore realizohet nëpërmjet tre formave *a)* transferimit, *b)* dekoncentrimit dhe *c)* delegimit. Këto forma rezultojnë në marrjen prej pushtetit vendor të tre llojeve të funksioneve : i) funksionet e veta ii) funksionet e përbashkëta dhe iii) funksionet e deleguara, të shoqëruara këto me kalimin e kompetencave përkatëse nga niveli qendror në atë vendor.

SKNDQV vë theksin mbi dy funksione si bazë të veprimtarisë së ardhshme të qeverisjes vendore: funksionet e veta dhe ato të përbashkëta. Për funksionet e deleguara (regjistri civil dhe sistemi i adresave) theksohet se “do t’i jepet fund menaxhimit kaotik të regjistrimit civil dhe sistemit të adresave, përmes zbatimit të projekteve konkrete.” Po kështu me shumë rëndësi është citimi i mëposhtëm në strategji se “decentralizimi si një proces në vazhdim do të synojë alokimin e funksioneve të reja edhe me ligje sektoriale, por duke aplikuar parimin e analizës funksionale dhe financimin e plotë të funksionit përpara decentralizimit të tij”.

Vullneti i shprehur më sipër në SKNDQV për alokim të funksioneve të reja me financim të plotë të funksionit përpara decentralizimit në mënyrë të pashmangshme do të ndeshet me probleme që tashmë janë hasur në vite. Ato kanë të bëjnë me hartimin e miratimin e standardeve për shërbimin, burimin e financimit dhe kompetencat e qartësuara të qeverisjes vendore në ligjet sektoriale.

Është për t’u përhëndetur fakti që në strategji sqarohet se “qeverisja vendore do mund të refuzojë funksionet që synohen t’i decentralizohen me ligje sektoriale nëse nuk ka një analizë funksionale dhe financim të plotë të funksionit”. Ky element përbën risi në lidhje me alokimin e funksioneve në të ardhmen, pasi vendos raport të caktuar midis rasteve të mundshme kur qeverisja qendrore këmbëgull për të transferuar dhe të drejtës për të mospranuar nga ana e qeverisjes vendore kur ajo e ka të argumentuar pamundësinë për të ekzekutuar funksionin.

Është e nevojshme që më parë të reflektojmë mbi termat e përdorura **“funksion” dhe “kompetencë”**, të cilat janë të pandashmenga njëra-tjetra, pasi në strategji nuk i është kushtuar shumë vëmendje përdorimit tyre.

Ligji organik përcakton 23 funksione të qeverisjes vendore. Realizimi me sukses i tyre nga ana e NjQV-ve ka hasur vështirësi të mëdha, si prej përcaktimit jo plotësisht të qartë të kompetencave ashtu edhe prej mungesës së mbështetjes së duhur financiare. Aktualisht, bashkitë dhe komunat, funksionet e veta mund t’i ushtrojnë nëpërmjet kompetencave të veta, ndërsa për funksionet e përbashkëta “kompetencat për funksionet e parashikuara..., rregullohen në çdo rast me ligj”. Për funksionet e qarkut, ligji organik shprehet se “qarku kryen dhe ushtron kompetencat e deleguara nga pushteti qendror...”. Po kështu në strategjinë e decentralizimit citohet se “kompetencat e deleguara

qarkut nga niveli i parë do të rishikohen nga pikëpamja e efikasitetit dhe efikasitetit të funksioneve të deleguara nga niveli qendror apo lokal”.

Marcou (2007) shprehet se “funksionet janë përmbajtja apo lënda e ushtrimit të kompetencave...” çështje që i shtrohen pushtetit vendor për të vepruar. Fjala “kompetencë” përdoret për të dhënë një ide të përgjithshme të objektit të tij ligjor, duke pasqyruar kufijtë brenda të cilit i takon të veprojë autoriteti që zotëron kompetencën. Kompetencat, në kuptimin e ngushtë të autoritetit, ekzistojnë vetëm përmes kombinimit të një funksioni (element lëndor) dhe të drejtat apo detyrat që autoriteti ushtron për këtë funksion. Pra funksionet nuk mund të analizohen pa autoritetin për të realizuar shërbimin, kombinimi i të cilave përcakton shkallën e lirisë të autoritetit të qeverisjes vendore. Autoriteti përmban kompetencën dhe financat e duhura për të realizuar një funksion. Nga ana tjetër kompetencat e autoriteteve lokale nuk mund të analizohen veçmas brenda vetes së tyre. Ato gjithmonë duhet të merren në konsideratë në kontekstin e marrëdhënieve mes autoriteteve lokale dhe qeverisë qendrore apo/edhe të autoriteteve rajonale.

Aktualisht komunat dhe bashkitë zotërojnë dy kategori: kompetenca të veta dhe kompetenca të deleguara, të ndara në kompetenca administrimi, shërbimi, investimi dhe rregullatore. Trajtimi i raportit funksion-kompetencë është me një rëndësi të veçantë pasi vlerësohet si përcaktues i gjithë veprimtarisë së qeverisjes vendore. Ligji i ri bazë për veprimtarinë e ardhshme të qeverisjes vendore detyrimisht do t’i referohet strategjisë së re, e cila shprehet se do të rriten kompetencat e qeverisjes vendore në fushën e rinisë dhe nuk përcakton se cilat lloj kompetencash do të jenë ato. **Planifikimi urban dhe administrimi i tokës mbeten kompetencë e bashkive dhe qarqeve për hartimin dhe miratimin e planeve të zhvillimit të territorit dhe lejeve të zhvillimit, por nuk ka përcaktime të forcimit apo dobësimit të rolit të kontrollit të territorit nga ana e NjQV-ve.**

Në Partneritetin Publik Privat (PPP) në nivel vendor është qartësuar fusha e bashkëpunimit, por mbetet e paqartë se çfarë lloj kompetencash do të ushtrohen nga palët. Ndoshta ligji i ri do të japë detaje të mëtejshme në këtë drejtim. Në zhvillimin e turizmit ka një përcaktim të qartë se bashkitë do të kenë kompetenca të shtuara në drejtim të organizimit të rrjetit të promovimit turistik lokal dhe rritjes së cilësisë së infrastrukturës lokale në shërbime të turizmit. Ndërsa për mbrojtjen civile ligji i ri do të rishikojë dhe përmirësojë kompetencat dhe rolin e autoriteteve vendore në fushën e mbrojtjes civile.

Tek funksionet e përbashkëta në pjesën “Arsimi parauniversitar” ka një përkujdesje për qartësimin e kompetencave mes NjQV-ve dhe Drejtoritë Arsimore Rajonale/Zyrat e Arsimit për shpërndarjen e nxënësve brenda zonës së juridiksionit të njërive vendore, ndërsa në “Shërbimin e kujdesit shëndetësor parësor”, do të përcaktohen qartë kompetencat e NjQV-ve lidhur me programe të ndryshme të shëndetit publik, të tilla si HIV, lufta kundër duhanit, etj., si dhe do të hartohen standardet e shërbimit dhe kostot për njësi. Është për t’u vlerësuar fakti se kompetencat e bashkive dhe qarqeve në planifikimin dhe në mbikëqyrjen e mbrojtjes së mjedisit do të forcohen nëpërmjet ndryshimeve ligjore dhe mbështetjes për ngritjen e kapaciteteve.

Funksionet

Në analizën e funksioneve kryesisht u morën nën shqyrtim raste kur:

- i. funksionet e veta që i janë dhënë me ligj qeverisjes vendore, por në ecurinë e viteve kanë patur ndërhyrje nga struktura qendrore që kanë deformuar kompetencat (furnizimi me ujë, kompetenca e administrimit nuk është e drejtpërdrejtë, kthimi në ndërmarrje sh.a është deformim, pa aprovim të vendorëve);
- ii. funksionet e veta që i janë dhënë ligjërisht qeverisjes vendore, por që janë ekzekutuar vetëm në drejtime apo sektorë të caktuara (shërbimi social- transferim i plotë, më pare, vetëm çerdhet);
- iii. funksionet dhe kompetencat e reja të paraqitura në SKNDQV (sistemi i ujitjes dhe kullimit).

Në këtë analizë u përdor metoda krahasimore e përmbajtjes së SKNDQV-së lidhur me dimensionin administrativ, në drejtim të:

- i. legjislacionit ekzistues për funksionet e kompetencat e veta dhe nivelit aktual të ofrimit të shërbimeve nga NjQV-të, bazuar në këtë legjislacion dhe reflektimit në strategji si perspektivë për të ardhmen;
- ii. potencialeve të mundshme të NjQV-ve për të marrë përsipër më shumë funksione e kompetenca të veta e të përbashkëta, referuar SKNDQV-së, krahasuar me problematikën që kanë krijuar deri në këto momente;
- iii. hapësirave të mundshme të NjQV-ve për të lëshuar funksione të veta e të përbashkëta që kanë patur mundësi t'i realizojnë aspak, pak apo mjaftueshëm, referuar SKNDQV-së;
- iv. frymës sëSKNDQV-së për të transferuar më tej, apo për të ruajtur situatën ekzistuese apo për të riqendëruar funksione e kompetenca të dhëna më parë NjQV-ve;
- v. objektivave e planeve të paraqitur në SKNDQV për të ndarë qartë kufijtë e funksioneve dhe kompetencave të përbashkëta midis qeverisjes qendrore dhe asaj vendore.

Reforma në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve

Neni 10, i ligjit organik e vendos funksionin e sistemimit të kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të ujërave të zeza, në funksionet e veta të komunës dhe bashkisë. Komuna/bashkia ka kompetenca të plota administrative, shërbimi, investimi dhe rregullatore.

Në SKNDQV, versioni shkurt 2015 vërehet se tek “Reforma në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve” janë përdorur terma të tillë si: “ndryshim rrënjësor”, “rishikim i të gjithë kuadri rregullator dhe financiar”, “standarte të reja”, “rivlerësim të tarifave”, “legjislacion për shërbimet publike/ndërmarrjet publike” si edhe “rikonfigurim/bashkim të aseteve”. Fokusi i ndërhyrjes ka një diapazon të gjërë. Në pamje të parë duket që gjithçka që është bërë do të zhbëhet. Një iniciativë shumë ambicioze, ndoshta e pamundur. Një vëzhgim më i detajuar të bën të mendosh se ky shërbim është tejmas kompleks dhe se sektori paraqitet se ecën me shumë vështirësi. “Ndryshim rrënjësor” do të

thotë shkulte nga themelet e tëgjithë punës së ngritur në më shumë se një dekadë, edhe pse për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet e ujërave të ndotura, qeverisja vendore me ligj ka përgjegjësi të plotë dhe të gjithë autoritetin e nevojshëm administrativ, shërbimi, investimi dhe rregullator. Në hapat e hedhura deri në këto momente, me ndryshimet ligjore të mëvonshme, menaxhimi u realizua në formën e Shoqërisë Aksionere(sh.a), ku drejtori i ndërmarrjes caktohet nga një Këshill Mbikqyrës, i zgjedhur nga Këshilli Bashkiak (Asambleja e Aksionarëve). Ky shërbim që përcaktohet me ligj në “funksionet e veta” të qeverisjes, dhe menaxhimi me ndërmarrje sh.a ka krijuar shpërndarje në hierarkinë drejtuese dhe ka vendosur marrëdhënie jo të drejtpërdrejta të titullarit të Bashkisë dhe drejtorit dhe stafit përkatës menaxhues të ndërmarrjes UK sh.a.

Nga ana tjetër, gjendja paraqitet tejmasë e vështirë në menaxhim dhe kërkon ndërhyrje emergjente afatshkurtër dhe ndërhyrje afatgjatë - jo vetëm “afatmesme” siç shprehet në strategji. Për më shumë, shpërbërja dhe ribërja kërkojnë shumë para dhe kohë, dhe kalon përtej afateve të përcaktuara të implementimit të vetë strategjisë, edhe pse në planin e veprimit të zbatimit të strategjisë janë përcaktuar disa afate kohore brenda pesë vjeçarit. Ideja e një përmbysje të madhe duket se nuk ka gjasa të bëhet realitet në favor të një shërbimi më të mirë. Një hap i hedhur më tej nga ç’është bërë deri në këto moment është më i mirë se shkatërrimi i asaj që është realizuar dhe më pas ringritja nga e para.

Analiza mbështetet në raportin e Entit Rregullator tëUjit (ERRU) për vitin 2014 ku shprehet se “në shumë njësi vendore furnizimi me ujë është me orar të reduktuar... rrjeti është i vjetëruar dhe shpesh... nuk ka mundësi të mirëmbahet siç duhet. Kemi 316 burime ujore, nga të cilët 223 janë me ngritje mekanike dhe kjo e fundit krijon konsum të energjisë elektrike dhe kosto tepër të lartë të shërbimit. Tarifat janë shumë më të vogla se kostot dhe jo rrallë me diferenca të mëdha; niveli i arkëtimit të faturimit është rreth 80 % dhe humbjet janë rreth 67 %. Vetëm 9 (nëntë) operatorë kanë arritur të mbulojnë me të ardhurat e tyre të gjitha shpenzimet e kryera për shërbimet e ofruara; kryesisht sh.a të mëdha të cilat kanë rritur me disa herë tarifat. Nga analizat e kryera del që kosto e punës merr 35% të kostos totale; energjia kap shifrën 26%; amortizimi 20%; riparime e mirëmbajtje 6%; të tjera 13%”.

Nga procesi konsultues me qarqet është kërkuar që të ndahen ujësjellësat nga sistemi i kanalizimeve të ujrave të zeza, madje shkohet edhe më tej e kërkohet të shikohet privatizimi i tyre. Kjo kërkesë është e mundshme dhe reflekton atë që është përcaktuar në strategji “nëpërmjet reformimit tërësor”, por ka pikëpyetje të mëdha për ta bërë realitet këtë kërkesë. Sistemi privat merret me tregtimin e ujit nga subjekte private të licencuar nga struktura të caktuara qendrore, të cilët e blejnë ujin nga depozitat publike dhe ia shesin atë qytetarëve. Futja në tregun privat mund dhe duhet të bëjë edhe një hap më tej: të lejojë ndërmarrjet e UK sh.a të futen në tregun e lirë privat të blerjes së ujit dhe t’ia shesin atë klientëve (konsumatorëve). Liberalizimi i tregut për ndërmarrjet UKsh.a do të ishte njëhap pa kosto dhe do të përputhej me vijueshmërinë e deritanishme të këtij shërbimi. Ketu privatizimi është prezantuar si zgjidhja e problemit; megjithatë, privatizimi nuk çon domosdoshmerisht në zgjidhjen e problemeve që karakterizojnë këte sektor.

Strategjia është baza mbi të cilën hartohen e miratohen ligjet. Prandaj është e domosdoshme të hartohet një ligj specifik për sektorin Ujësjellës-Kanalizime, pasi nuk ka një ligj bazë i cili të rregullojë mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tij. Aktualisht, ky sektor funksionon mbi bazën e disa akteve ligjore e nënligjore direkte (mbi 10 ligje e akte nënligjore që merren me problemet e menaxhimit të ujërave) dhe një sërë aktesh të tjera ligjore e nënligjore të cilat ndikojnë indirekt në sektor. Mospasja e një ligji të posaçëm ka sjellë një sërë problematikash, ku ndër të tjera mund të përmendim:

- a) Të drejtat dhe detyrat e personave fizikë dhe juridikë që ofrojnë shërbimin në sektorin ujësjelles kanalizime janë të paqarta;
- b) Të drejtat dhe detyrimet e institucioneve publike të përfshirë në këtë sektor kanë mbivendosje kompetencash ose këto kompetenca janë të paqarta; dhe
- c) Mungon një model i zhvillimit të tregut dhe një mirë-përcaktim i rregullave për funksionimin e tij.

Po në këtë dokument trajtohet pronësia e aseteve të sistemeve ujësjellës e kanalizime, të cilat janë transferuar në mënyrë graduale me VKM pranë njësite vendore, në zbatim të reformave të decentralizimit dhe të funksioneve të NjQV-ve, sipas ligjit për qeverisjen vendore. Ka një mungesë të theksuar dokumentacioni. Regjistrat e aseteve të shoqërive UK sh.a nuk përditësohen për t'i përfshirë në inventarin vjetordhëpër çertifikimin e tyre në ZRPP. Asetet e përfituara nga investimet e kryera nga njësite e qeverisjes vendore si aksionare të shoqërive UK sh.a, nuk janë pjesë e inventarit të sistemeve UK sh.a të këtyre shoqërive. Gjithashtu, NjQV-të që nuk janë pjesë e juridiksionit të shoqërive UK sh.a, kanë ndërtuar sistemet e tyre të furnizimit me ujë, për të cilat aktualisht nuk ka informacion. Kjo situatë vijon të jetë në ngërç.

Për zgjidhjen e problemeve të mësipërme kërkohen politika dhe strategji përkatëse mbi hapat sesi do të arrihen objektivat e politikave të menaxhimit në të ardhmen. Në kuadër të projektit “Fuqizimi i Strukturave të Pushtetit Vendor dhe Bashkëpunimit të Përfaqësuesve të Zgjedhur Vendorë në Shqipëri (2012-2015)”, zbatuar nga Këshilli i Evropës dhe financuar nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Shoqatat e qeverisjes vendore shprehen se “transferimi i plotë i varësisë së sistemeve të ujësjellësave prej njësite vendore duhet analizuar rast pas rasti duke përcaktuar në mënyrë të qartë të drejtat dhe detyrimet e palëve me anë të rregullimeve ligjore”. U propozua ndarja e prodhimit të ujit nga furnizimi i popullatës ku bashkitë të kenë përgjegjësi me kompetenca të plota nga deponizimi deri tek qytetari.

Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve me karakter vendor, trotuar e vedhesheshëve publike

Për këtë funksion SKNDQV ka prekur këto çështje kryesore: rritjen e kapaciteteve menaxhuese, inventarizimin e rrugëve dhe miratimin e standarteve dhe bashkëpunimin e PPP-ve.

Në bazë të ligjit organik funksioni i “Ndërtimit, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve me karakter vendor, trotuarve dhe shesheve publike” radhitet në funksionet e veta të komunës dhe bashkisë. Aktualisht, bashkitë kanë kompetencën ligjore, administrative, shërbimi, investimi dhe vendosjen e standardeve dhe rregullave për organizimin e shërbimit të mirëmbajtjes dhe rehabilitimit në rastin kur investojnë nga buxheti i vet, si edhe kur investohet nga fonde prej donatorësh apo agjensish. Strategjia ka prekur pozitivisht hallkat më të dobëta të këtij funksioni, ku për t’u veçuar është emergjenca e hartimit dhe miratimit të standardeve.

Mbetjet urbane

Për menaxhimin e mbetjeve urbane, sipas ligjit organik njësitë vendore kanë patur përgjegjësi dhe autoritet të plotë në garantimin e shërbimit të mbledhjes, transportit dhe trajtimit të tyre në vendgrumbullim. Sasia e madhe e prodhimit në rritje të mbetjeve urbane, ka rritur koston në ofrimin e shërbimeve. Në shërbimin e pastrimit, si një nga shërbimet bazë që duhet të kryejë qeverisja vendore, situata është mjaft e rënduar. Në pjesën më të madhe të komunave dhe në një numër të caktuar bashkish, nuk ka patur asnjë vend depozitimi për mbetjet e grumbulluara sipas standardeve dhe vendet ku shërbimi mungon, mbetjet depozitohen ose në vende depozitimi të pa çertifikuara ose hidhen në shtretërit e lumenjve.

Kuadri ligjor përfshin një sërë ligjesh të tjera, VKM dhe udhëzime, të cilat kanë për qëllim të rregullojnë edhe grumbullimin dhe largimin e llojeve të tjera të mbetjeve. Vlen për t’u theksuar VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim” ka përcaktuar qëllim të ri për të sjellë në vëmendje të qeverisë vendore përgjegjësinë e tyre për grumbullimin e diferencuar dhe riciklimin e mbetjeve të ngurta. Afati për këtë detyrë është viti 2016.

Duke iu referuar hierarkisë së menaxhimit të integruar të mbetjeve e cila përfshin parandalimin, riciklimin, ripërdorimin, rigjenerimin për prodhim energjie, dhe në fund eliminimin me anën e kompostimit apo proceseve të tjera të mëtejshme, kuptojmë qartë se realiteti ynë ka mbetur në fazën fillestare dhe është shumë larg ndaj asaj që kërkohet nga ana e standardeve të BE-së.

SKNDQV trajton dy momente të rëndësishme në pikën 2.4.1 Funksionet e veta (Mbetjet urbane). Saktësimi se “menaxhimi i landfilleve do të rikonsiderohet në kuadrin e ri të shpërndarjes së kompetencave midis niveleve të ndryshme të qeverisjes vendore” përbën një hap pozitiv shumë të rëndësishëm për ndarjen e saktë të kompetencave në nivelet përkatëse të qeverisjes vendore, duke çliruar bashkitë e reja nga barra e rëndë e mbetjeve. Historia e së kaluarës tregon se “gishti” i fajësisë është drejtuar gjithmonë drejt tyre. Ndërsa, hedhja në treg duke nxitur PPP në nivel vendor konsiderohet hap pozitiv në menaxhimin e integruar të mbetjeve. Në lidhje me menaxhimin, mund të veçohen këto pika për trajtim:

- i. Strategjia duhet të trajtonte edhe bashkëpunimin ndërvendor, duke iu referuar instrumenteve ligjorë, organizativë dhe administrativë që do të rregullonin këtë bashkëpunim në menaxhimin sa më të mirë të mbetjeve urbane;

- ii. Strategjia duhet të ketë edhe objektiva akoma më afatgjatë në këtë shërbim vendor, duke përcaktuar objektiva më shumë se pesë vjeçare të qeverisë. Kjo do të pasqyrojë një dinamikë më të qartë të ecurisë në këtë drejtim.
- iii. Tashmë është e ditur se ka dy drejtime kryesore për përmirësimin të këtij shërbimi: hartimi, miratimi dhe zbatimi i ligjeve të përafërta me legjislacionin evropian dhe edukimi shkollor. Edukimi shkollor duhet të zëjë vend më të rëndësishëm për suksesin afatgjatë të këtij shërbimi. Meqënëse kjo është një strategji ndërsektoriale edhe objektivat për bashkëpunimin me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, duheshin trajtuar më qartë në këtë pikë.

Shërbimet sociale dhe të përkujdesit social

Funksioni i shërbimit social vendor do të decentralizohet dhe do të kalojë në kompetencë të bashkive. Nga termat prioritare në strategji mund të veçohen a) hartimi i një 'shporte shërbimesh bazë' me financim nga buxheti shtetit, b) hartimi i Planeve Lokale Sociale nga bashkitë dhe kompetenca për të ofruar shërbime shtesë përtej 'shportës së shërbimeve bazë' me financim nga buxhetet lokale duke krijuar Fondin Social Lokal, si dhe c) përmirësimin e kapaciteteve menaxhuese dhe cilësisë së shërbimeve sociale në lidhje me jetimoret, qendrat ditore, shtëpitë e të moshuarve, etj. Listat e shërbimeve dhe standardeve minimale do të hartohen nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Kjo përpjekje për decentralizim të plotë është për t'u përshëndetur, por do të ishte me shumë vlerë nëse do të përcaktohej më parë masa e financimit të këtij funksioni nga buxheti i shtetit, pravlera në shifra e shportës e pastaj ndërhyrja nga buxhetet vendore.

Bashkia ka patur kompetenca të plota administrative, shërbimi, investimi dhe rregullatore vetëm për ngritjen dhe funksionimin e çerdheve të fëmijëve në territorin e tyre, objektet e të cilave aktualisht janë pronë vendore. Këshilli i bashkisë ka të drejtë të miratojë kritere specifike për të ofruar shërbime të përkujdesit shoqëror. Strategjia shprehet qartë se pushteti vendor do të ketë kompetenca të plota administrative dhe shërbimi, investimi dhe rregullator në këtë shërbim.

Strehimi social

Strategjia parashtron nxitjen e bashkëpunimit në PPP ose me Organizatat jo-fitim prurëse (OJF), inkurajimin e bashkive për hartimin e miratimin e planeve 10-vjeçare të strehimit social, si edhe mbështetje për rritje kapacitetesh për administrimin e kërkesave për përballimin e këtij shërbimi.

Neni 10 i ligjit organik e vendos funksionin e shërbimit të strehimit në funksionet e veta të bashkisë, ndërsa ligji numër 9232, datë 13.5.2004, "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane" është rregullatori kryesor për dhënien e këtij shërbimi nga bashkitë. Bashkitë nuk kanë pengesë në aspekt të ushtrimit të kompetencës administrative/shërbimit (administrimi i kërkesave dhe përcaktimi dhe disponimi i truallit). Ndërsa për kompetencën e investimit (e drejta për planifikimin e investimit, për ekzekutimin, për sasinë e fondeve dhe formën dhe vendin ku do të investohen), ligji sqaron se banesat me kosto të ulët sigurohen nëpërmjet ndërtimit ose blerjes nga tregu me fondet e buxhetit të shtetit, me fondet e bashkisë, nëpërmjet donacioneve private dhe nëpërmjet nxitjes së nismës private.

Në referim të kompetencave rregullatore, këshillat bashkiakë kanë të drejtën e rivendosjes së kushteve për përfituesit brenda kufijve të përcaktuara me ligj, ndërsa standardet për dokumentacionin dhe procedurat e blerjes nga tregu përcaktohen me VKM. Gjithashtu, normat e strehimit, përcaktohen me VKM, ndërsa kufijtë minimalë dhe maksimalë të të ardhurave të familjeve, që përfitojnë banesa sociale me qira përcaktohen me ligj. Brenda këtyre kufijve, NjQV-të me vendim të këshillave përkatëse kanë të drejtën e rivendosjes së këtyre kushteve. **Roli i Komitetit Kombëtar të Strehimit nuk është përcaktuar qartë pasi nga funksioni konsultues ky komitet është veshur me autoritet vendimmarrës, veprim që cënon apo mbivendoset me kompetencat e qeverisjes vendore.**

Ujitja dhe kullimi

Përfshirja e SKNDQV e këtij funksioni vlerësohet pozitivisht. Bashkitë e reja do të përfshihen në një territor të ri, ku një pjesë e konsiderueshme do të jetë edhe tokë bujqësore. Parimi i subsidiaritetit mishërohet qartë: *shërbimi sa më afër qytetarit*. Kërkohej më shumë vëmendje dhe kujdes me ligjin përkatës që do të hartohet për këtë funksion të ri. Ai duhet t'i përmbahet parimit të caktuar në këtë strategji se çdo funksion i dhënë do të shoqërohet edhe me kompetencat përkatëse mbështetur me fonde. **Kjo do të thotë që ligji i ri duhet të ketë shprehje të qartë se fondet e dhëna qeverisjes vendore duhet të jenë të paktën të barabarta me ato që ka harxhur deri në këto moment Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për kryerjen e këtij shërbimi.** Gjatë procesit të konsultimit të strategjisë u cilësua se Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit, akoma nuk e kanë mundësinë të kalojnë nëvartësi të NjQV-ve. Kjo mund të ndodhë në një kohë të ardhme.

Turizmi

SKNDQV nuk ka përfshirë atë që është më kryesore: turizmi në radhë të parë është mënyrë jetese, mënyrën e jetesës e bëjnë njerëzit dhe njerëzit operojnë sipas rregullave që vendosen prej qeverisjes qendrore apo/edhe vendor. **Strategjisë i mungojnë objektivat dhe instrumentat që inkurajojnë performancën e duhur për të kryer një shërbim turistik (detyrë kjo më së shumti e qeverisjes vendore).** Turizmi është veprimtari që kërkon bashkëveprim të nivelit të lartë të disa institucioneve qendrore e vendore. Transporti ajror, detar e tokësor, bankat me shërbimet e tyre, shërbimi mjekësor, parkimet publike etj. duhet të gjejnë shprehje të pozicionit të tyre në këtë pjesë të strategjisë, ndoshta me ndërhyrje e ndryshime ligjore sektoriale.

Planifikimi urban

Sipas ligjit organik dhe SKNDQV, versioni shkurt 2015, në kushtet e ndarjes së re administrative, bashkitë do të ushtrojnë kompetencat të plota për këtë funksion, duke përfshirë planifikimin, dhënien e lejeve dhe kontrollin e territorit. Edhe pse është një e drejtë ekskluzive, e drejta për të vendosur dhe mbledhur taksën mbi infrastrukturën për ndërtimet e reja, me ligj nuk është nën autoritetin e bashkive. Lejet e ndërtimit, pasi janë nxjerrë mbi bazën e planit nga institucioni i bashkisë, duhet të rikonfirmohen nga Agjencia Kombëtare për Planifikimin e Territorit, duke barazuar kështu autoritetin e këtij institucioni me atë të bashkive. Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe Inspektoriati Ndërtimor dhe Urbanistik Vendor shpesh gjenden në përballje institucionale. Ligji i ri

organik duhet të adresojë këtë situatë me ndërhyrje të qarta ligjore për të ndarë qartë përgjegjësinë për kontrollin e territorit dhe inspektimin e ndërtimit, dhe kthimin e këtij institucioni në kuadrin e vet ligjor sipas Kartës Urbane Evropiane.

Arsimi parauniversitar

Ka një shprehje vullneti të plotë për ndarjen e saktë të kompetencave në këtë fushë. Në versionin përfundimtar të SKNDQV, pika 2.4.2 “Funksionet e përbashkëta”, në pjesën “Arsimi parauniversitar”, thuhet se “kujdes do të bëhet për qartësimin e kompetencave mes NjQV-ve dhe DAR/ZA për shpërndarjen e nxënësve brenda zonës së juridiksionit të njërive vendore”. Në procesin konsultues të SKNDQV-së në takime në qarqe, u kërkuan më shumë kompetenca në edukim, pa përcaktuar se kush mund të jenë ato. Vite më parë, kompetenca e investimeve si fonde të kushtëzuara u ushtrua nga disa prej bashkivetë mëdha, por tashmë NjQV-të paguajnë pagat e punonjësve, fondet operacionale dhe fondet për mirëmbajtjen e shërbimit.

Në vitin 2004, me VKM, u miratua dokumenti “Për politikën e decentralizimit në sektorin e arsimit parauniversitar”, ku pushteti vendor u përcaktua pronar i objekteve dhe mjeteve themelore brenda këtij sektori. NjQV-të kujdesen për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e objekteve shkollore, për planifikimin dhe zbatimin e investimeve, për ndërtimin, rikonstruksionin dhe paisjen me bazë materiale të shkollave. Është për të vënë në dukje se tashmë institucionet private të edukimit parauniversitar, janë një realitet që nuk mund të anashkalohen. **Strategjia nuk e ka marrë në konsideratë këtë sektor privat dhe nuk ka paraqitur objektiva lidhur me raportet e pushtetit vendor apo qendror me këto institucione në lidhje me funksionet dhe kompetencat përkatëse.**

Shërbimi i kujdesit shëndetësor parësor

NjQV-të kanë rol të kufizuar në zbatimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor. Është analizuar ndikimi i zbatimit aktual nga NjQV-të i funksioneve të përbashkëta në sistemin e kujdesit shëndetësor parësor, si rrjedhojë e reformës administrativo-territoriale. Legjislacioni aktual do të rishikohet për të sqaruar rolin dhe përgjegjësinë institucionale për mirëmbajtjen e infrastrukturës fizike të institucioneve të kujdesit shëndetësor parësor, të cilat janë pjesë e aseteve në pronësi të pushtetit vendor. Kompetencat e NjQV-ve lidhur me programe të ndryshme të shëndetit publik, të tilla si HIV, lufta kundër duhanit, etj., do të përcaktohen qartë, si dhe do të hartohen standardet e shërbimit dhe kosto për njësi. Transferimi i kompetencave të tjera në këto fusha do të bëhet në bazë të një sërë kriteresh të paracaktuara dhe pas vlerësimit të kapaciteteve të NjQV-ve për zbatimin e tyre.

Shpesh NjQV-ve u kërkohet që të mbajnë përgjegjësi për garantimin e shërbimit shëndetësor parësor si dhe atë spitalor, kur në realitet ato kanë autoritet të kufizuar administrativ, shërbimi, investimi dhe rregullator. Ligji nr.10 107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 5, përcakton përgjegjësitë dhe të drejtat e pushtetit vendor, ku mund të përmendim si më të rëndësishëm “administrimin e objekteve të shërbimit të kujdesit shëndetësor, të cilat janë në pronësi të tyre dhe kontrollin administrativ për veprimtarinë shëndetësore në territorin që administrojnë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, por gjithmonë në koordinim me Ministrinë e Shëndetësisë”. Pikat e tjera në këtë nen të ligjit janë të përgjithshme dhe jo konkrete.

Qarku në sistemin e shëndetësisë mban dhe harton evidenca të investimeve qendrore në nivel vendor: evidenca të inventarit të kapitaleve (ndërtesa, ambulanca, qendra shëndetsore) për sistemin e shëndetësisë në qark, të konfirmuara nga Drejtoria e Shëndetit Publik në qendër qarku. Strategjia për këtë shërbim është shprehur qartë duke pozicionuar qeverisjen qendrore dhe atë vendore dhe duke lënë të nënkuptuar se qarku nuk do të jetë i përfshirë në marrjen e kompetencave përkatëse.

Në mënyrë të përmbledhur, strategjia ka përcaktuar qeverisjen qendrore dhe bashkinë si institucione përgjegjëse për menaxhimin e shërbimit. **Në këtë strategji është shprehur vullneti për të forcuar dhe qartësuar mekanizmat ligjor mbi të cilat ky menaxhim mund të realizohet.** Proceset që do të kryhen për menaxhimin do të jenë atribut i vetëm dy palëve: qeverisjes qendrore dhe asaj vendore (bashkitë).

Dimensionin Financiar

Në seksionin 4.3, strategjia deklaron “Qëllimi kryesor i reformave të decentralizimit fiskal do të jetë të krijohet mundësi që qeveritë vendore të kenë më shumë burime financiare, në mënyrë që ato të kryejnë funksionet dhe kompetencat e tyre në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme.

Objektivat kryesorë të strategjisë në këtë fushë janë:

- Të rrisë kapacitetin e të ardhurave vendore të NjQV për të përmbushur nevojat financiare për ofrimin e më shumë shërbimeve;
- Të përmirësojë qëndrueshmërinë, thjeshtësinë dhe barazinë e sistemit të transfertave së bashku me rritjen e transparencës;
- Të sigurojë më shumë kapacitete për NjQV që të përdorin huamarrjen dhe borxhin për financimin e investimeve kapitale brenda politikave kombëtare të borxhit publik;
- Të forcojë sistemin e administrimit të financave publike në nivel vendor.

Do të zbatohen disa masa prioritare në fusha të caktuara të decentralizimit fiskal me qëllim forcimin e situatës financiare të NjQV.”

Strategjia e rishikuar bën një hap të rëndësishëm në përcaktimin e objektivave kryesorë financiarë që synohen të arrihen nëpërmjet rishikimit të kuadrit ligjor dhe fiskal për njësitë e qeverisjes vendore duke marrë përsipër angazhimin për rritje të peshës së shpenzimeve të pushtetit vendor ndaj PBB dhe buxhetit të konsoliduar. Po ashtu, strategjia përcakton qartë nëpërmjet treguesve të matshëm edhe objektivin për të ndryshuar strukturën e të ardhurave të njëjësive të qeverisjes vendore në favor të të ardhurave të veta dhe diskrecionare.

Taksat dhe tarifat vendore

Strategjia përcakton se “autoritetet vendore do të përcaktojnë bazën dhe nivelin e taksave”. Rishikimi dhe miratimi i legjislacionit përkatës, si projektligji “Për financat vendore”, ligji organik, dhe ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e

Shqipërisë”, do të bëhet me qëllim përcaktimine përputhshmërisëse tyre me Kartën Evropiane, për të përcaktuar bazën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore në përputhje me legjislacionin tatimor. Në përgjithësi, normat treguese të taksave të përcaktuara me ligj do të rishikohen dhe NjQV–ve do t’u jepet më shumë liri veprimi për përcaktimin e nivelit dhe bazës së taksës (në varësi të llojit të taksës). Do të prezantohen rregullat specifike për llogaritjen e tarifave vendore.

Vlen të përmendet se në sistemin aktual në përgjithësi niveli i taksës është i përcaktuar me ligj dhe ndryshime të herëpashershme të kuadrit ligjor kanë rritur ose ngushtuar diskrecionin vendor në rritjen apo uljen e nivelit statutor të taksës. Në mungesë të sugjerimit nga projekt strategjia për ndonjë taksë të re vendore; mund të konkludojmë se **autoriteti vendor për përcaktimin e taksave do të rregullohet për taksat e pasurisë dhe taksën e ndikimit në infrastrukturë**. Do të kishte qenë me vend që strategjia të diskutonte më në hollësi planet për:

- a) Rishikimin e niveleve të taksës së pasurisë dhe korigjimin e pabarazive të theksuara në nivelet e taksave. Për shembull, një banesë në qendër të Tiranës taksohet aktualisht me një nivel që arrin në maksimumi 30 lekë/m² në vit nëse kjo e fundit është një banesë e dyte; ndërkohë që një banesë në një fshat të Kavajës brenda territorit të ish fshatrave turistike mund të taksohet deri në nivelin 800 lekë/m² në vit si banesë e dytë, ose pothuaj 27 herë më shumë se banesa në qendër të Tiranës e cila natyrisht ka rentë potenciale disafish më të lartë se banesa në fshatin e Kavajës. Për më tepër, me ligjin për privatizimin e trojeve në territoret e ish-fshatrave turistike këto banesa kanë tashmë status të njëjtë me ato të banesave të tjera në bregdet të cilat taksohen me nivelin e taksës së aplikuar në komunat përkatëse. Së dyti, ekspertë të ndryshëm dhe në veçanti urbanistë llojnë prej vitesh për futjen e taksës së truallit si një mekanizëm financiar për zhvillimin e tokës.
- b) Rishikimi (qartësimi i përkufizimit të vlerës së investimit) i bazës së taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe në veçanti nivelet e ndryshme të aplikueshme për lloje të ndryshme zhvillimi në varësi të infrastrukturave shtesë që nevojiten si rezultat i këtyre zhvillimeve: për shembull, ndërtimi i një hidrocentrali nuk ka ndikim të njëjtë shtesë mbi infrastrukturën ekzistuese si ndërtimi i një banese shumëkatëshe apo një shkolle.
- c) Parimet për llogaritjen e tarifave vendore mund të jenë subjekt i studimeve të hollësishme që nuk i përkasin kësaj strategjie. Megjithatë, do të ishte me vend që strategjia të përcaktonte në mënyrë deklarative këto dy parime: së pari, parimin që përdoruesi paguan (i.e. ndotësi paguan në rastin e tarifës së pastrimit) dhe që tarifa duhet të mbulojë koston e shërbimit dhe të mos shkojë përtej saj. Gjithashtu, do të ishte me vend që të përmendej edhe politika diskriminuese e pushteteve vendore në vendosjen e tarifave sot përkundrejt bizneseve, të cilat ngarkohen me kosto shumë të larta tarifash në shpërpjesëtim me barrën që ato shkaktojnë mbi shërbimet. Për shembull, një zyrë nuk ndot detyrimisht më shumë se një familje, por paguan mesatarisht 10 herë më shumë tarifë pastrimi; çka shkon në kundërshtim me logjikën e përllogaritjes së tarifave. Natyrisht, administrimi i tarifës për subjektet familjare është shumë më i vështirë në kushtet e sotme, por politikat e forcimit të pushteteve vendore duhet të përqendrohen gjithmonë e më shumë në forcimin e kapaciteteve për menaxhimin e taksave dhe njohjen e përdorimit të instrumenteve ligjore që edhe aktualisht kanë në dispozicion për sigurimin e pagimit të taksave (tax enforcement). Këto elemente duket se

kanë qenë në synimin e hartuesve të strategjisë, por do të kishte qenë më vlerë të bëheshin të njohura në mënyrë të qartë.

- d) Në rastin e taksave të përbashkëta, u përmend edhe më lart se strategjia përmban një pohim të dobët mbi synimin për ndarjen e taksave si TAP apo TTF. Në rast se qeveria synon vërtet të ecë përpara në këtë drejtim, do të kishte qenë me vlerë që strategjia të përmbante një mendim më të pjekur për mënyrën e ndarjes së taksave (p.sh. sipas pikës së mbledhjes; në përpjesëtim me popullsinë banuese; në përpjesëtim me popullsinë e qarkut; si financim i fondit total të granteve të cilat rishpërndahen me mekanizma të tjerë, etj.).

Transferrat ndërqeveritare

Strategjia përcakton se “Do të rishikohet kuadri ligjor për të përmirësuar kriteret për ndarjen e transfertave të granteve për pushtetin vendor. Rregullat për barazimin vertikal dhe horizontal dhe rregullat fiskale që synojnë të sigurojnë disiplinën fiskale në nivel vendor do të përfshihen në legjislacion.”. Në vite kritika kryesore në lidhje me formulën ekualizuese të grantit të pakushtëzuar kishte të bënte me moskuptimin p.sh. mungesën e transparencës së saj. Rezultatet e formulës kanë siguruar barazi dhe mundësi financimi edhe për komunitete më të cënueshme, siç vihet në pah edhe nga një studim i thelluar i BB mbi pushtetin vendor në vitin 2009³², i cili e vlerëson këtë sistem. Është për t'u përsëritur qëllimi që **kriteret ekualizuese vertikale dhe horizontale do të sanksionohen me ligj**. Do të ishte edhe më pozitive nëse strategjia do të shprehej mbi synimin ose jo për ndryshimin drastik të këtyre kriterëve në krahasim me sistemin aktual, përfshirë edhe synimin për të futur kriteret të reja (për shembull përbërja demografike e cila kërkon strukturë të ndryshme shërbimesh e kostosh), baza për ekualizimin fiskal (për shembull, kalimi drejt një baze tase më të qëndrueshme dhe më lehtë të llogaritshme siç mund të jetë taksat e pasurisë) apo shkalla e ekualizimit.

Huamarrja vendore

Versioni shkurt 2015 i strategjisë së decentralizimit shpreh synimin për forcimin e kapaciteteve vendore për huamarrje lokale, përfshirë forcimin e praktikave të menaxhimit financiar dhe auditimit. Së pari, vlen të përmendet se kuadri ligjor për paaftësinë paguese nuk është miratuar asnjëherë, ndonëse një draft i hershëm i këtij ligji ishte përgatitur nga ekspertët që punuan për ligjin e huamarrjes vendore që në fazat e para. Në kontekstin e krizës aktuale dhe problemeve të shumta të financimit, një pjesë e madhe e pushteteve vendore do të duhet të kishin kaluar në administrim të kontrolluar nëse ky kuadër ligjor do të ishte miratuar ndonjëherë. **Strategjia mund titrajtonte këto çështje më në detaj, duke marrë në konsideratë edhe mundësinë që huamarrja të mos jetë e lejueshme në mungesë të një auditimi paraprak nga një ekspert i pavarur**. Gjithashtu, do të ishte me vlerë t'i jepej përgjigje edhe çështjes së bashkëndarjes së kufirit të borxhit publik mes qeverisë qendrore dhe atyre vendore, në përpjesëtim me pjesën që shpenzimet e tyre kanë në shpenzimet publike të konsoliduara.

³² The World Bank. (2008). *Albania Local Finance Policy Note*.

Forcimi i PFM në nivel vendor

Aksesi i pushtetit vendor në sistemin AMoFITS përmendet por pa saktësuar data specifike pra duke mos krijuar një objektiv detyrues. Strategjia ka përfshirë nevojën për regjistrimin e angazhimeve dhe kontrollin e tyre në sistemin e thesarit siç është rekomanduar. Megjithatë, kjo lidhet me aksesin e njësive në AMoFITS si një mënyrë për të forcuar PFM dhe shmangur borxhet e fshehura. **Strategjia nuk përmend në mënyrë specifike nevojën për shtrirjen dhe forcimin e reformave të kontrollit dhe auditimit të brendshëm, PIFC dhe procedurat për auditimin e jashtëm edhe në pushtetin vendor.**

Perceptimet e aktorëve qendrorë dhe vendorë

Aksesi në informacion dhe njohuritë rreth strategjisë

Pak më shumë se gjysma (ose 55%) e zyrtarëve vendorë raportuan se zotërojnë një kopje të strategjisë. Përgjithësisht, **aktorët qendrorë kanë pasur më tepër akses në dokumentin e strategjisë së decentralizimit sesa zyrtarët vendorë.** Të dhënat sasiore zbulojnë se pjesa dërrmuese e aktorëve qendrorë të anketuar zotëron të paktën një kopje fizike ose elektronike të strategjisë. Në pjesën më të madhe të tyre, ata deklarojnë se e kanë siguruar dokumentin me postë elektronike ose fizike nga stafi i MSHÇV. I njëjti konkluzion qëndron edhe për zyrtarët vendorë.

Zyrtarët vendorë rendisin lidhjet personale si burimi i dytë më i shpeshtë i sigurimit të strategjisë (në 36% të rasteve). Burime të tjera janë: Shoqata e Bashkive (14%), Shoqata e të Zgjedhurve Vendorë (4%), Shoqata e Komunave (7%), dhe faqja zyrtare e ministrisë (7%).

Orientimi politik i njësive vendore shfaqet si faktor ndikues në perceptimet e zyrtarëve rreth aksesit të tyre në informacion. Në këtë linjë, njësitë me orientim të djathtë, krahasuar me njësitë me orientim të majtë, raportuan se kanë pasur më pak mundësi aksesit në informacion. Kësisoj, 62% e njësive ku ka fituar “Aleanca për të Ardhmen” zotërojnë një kopje krahasuar me 53% të njësive ku ka fituar “Aleanca për Qytetarin”.

Anketat zbuluan gjithashtu se aktorët e targetuar kanë pasur interes të veçantë në përthithjen e informacionit lidhur me strategjinë duke u angazhuar në diskutime në grup ose nëpërmjet hulumtimeve personale. Në pjesën më të madhe të tyre (rreth 78%) zyrtarët vendorë deklarojnë se kanë njohuri mesatare ose të mira rreth strategjisë së decentralizimit krahasuar me 13% prej tyre që cilësojnë se nuk kanë aspak njohuri ose kanë njohuri të pakta. Aktorët qendrorë raportojnë se janë më të mirëinformuar krahasimisht me aktorët vendorë. Pjesa dërrmuese e aktorëve qendrorë shprehen se kanë njohuri të mira ose shumë të mira rreth strategjisë së decentralizimit. **Diskutimet në grup, kontaktet dhe hulumtimet personale rezultojnë të jenë burimet kryesore ku janë mbështetur njohuritë e palëve mbi strategjinë.** Këto burime përkrijnë për të dy grupimet e anketuara.

Përmbajtja e strategjisë së decentralizimit

Në pjesën më të madhe të rasteve aktorët e interesit pajtohen me vizionin e përgjithshëm dhe objektivat strategjikë të cilësuar në strategji. Megjithatë, ata shfaqen disi të paqartë me mënyrën sesi do të përmbushen këto objektiva ose në lidhje me aspekte të tjera përmbajtësore të strategjisë. **U vu re një valë skpticizmi dhe mosbesimi në lidhje me përmbushjen e objektivave strategjikë.**

Ndarja bashki/komunë dhe orientimi politik priren të jenë faktorë përcaktues në këto perceptime. Pjesadërrmuese e aktorëve vendorë dhe qendrorë pajtohen me vizionin e strategjisë: “Fuqizimi i qeverisjes vendore dhe i procesit të decentralizimit me qëllim që të sigurohet një efikasitet më i lartë i vetë qeverisë vendore”. Ky nivel pajtimi arrin të ruhet pavarësisht pozicionit që mbajnë zyrtarët në qeverisjen vendore ose ndarjes sipas bashkive dhe komunave.

Zyrtarët vendorë priren të shfaqin besim në përmbushjen e objektivave të strategjisë. Megjithatë, një numër i konsiderueshëm i tyre nuk janë të qartë se si do të përmbushen këto objektiva. Konkretisht, 82% e zyrtarëve vendorë deklarojnë se kanë pjesërisht besim ose kanë besim në përmbushjen e objektivave. Kjo shifër zbret në 63% kur bëhet fjalë për qartësinë në realizimin e objektivave. Kjo tendencë vihet re edhe në kampionin e aktorëve qendrorë.

Niveli i qartësisë dhe besimit në përmbushjen e objektivave strategjikë varion sipas orientimit politik dhe ndarjes bashki/komunë. Kjo ndodh pasi që mjedisi shqiptar është karakterizuar kahera nga konfliktet politike dhe si rrjedhojë orientimi politik mund të jetë faktor në besimin që kanë palët lidhur me përmbushjen e objektivave. Ndërkaq, komunat të cilat do të suprimohen sipas Reformës Territoriale shfaqin probleme paqartësie ose mungesë besimi.

Gjysma (50%) e zyrtarëve vendorë të bashkive deklarojnë se janë pjesërisht të qartë sesi do të përmbushen objektivat strategjikë të cilësuar në Strategjinë e Decentralizimit krahasuar me vetëm 28% të zyrtarëve të komunave. Shumica dërrmuese (96%) e zyrtarëve me orientim të majtë shprehën se kanë pjesërisht besim ose kanë besim në përmbushjen e objektivave strategjikë, krahasuar me 67% të zyrtarëve me orientim politik të djathtë.

Të dhënat cilësore zbulojnë disa prej arsyeve të paqartësisë së zyrtarëve vendorë. Kështu, **pjesëmarrësit në fokus grupe u shprehën se nuk ishin ende të qartë sesi do të bëhet ndarja e përgjegjësive midis qeverisë qendrore dhe njësive vendore.** Ata sugjerojnë që mënyra e ndarjes së përgjegjësive duhet të informohet nga interesat e njësive vendore dhe jo ato të qeverisë qendrore. Ndarja e fondeve nga qeveria qendrore në njësitë vendore mbetet gjithashtu e paqartë. Përfaqësuesit e njësive vendore u shprehën se ndarja duhet të mbështetet në disa kritere. Njësitë vendore duhet të jenë të informuara rreth kriterëve si dhe qeveria qendrore të jetë transparente.

Një shqetësim tjetër që ishte i pranishëm në çdo takim të zhvilluar lidhet me funksionet e qarkut të cilat mbeten ende të paqarta në strategji. Megjithatë, midis pjesëmarrësve nuk kishte konsensus rreth funksioneve që duhet të ketë qarku. Përfaqësuesit e institucionit të Këshillit të Qarkut argumentuan

se duhet të rriten kompetencat e qarkut, ndërkohë përfaqësuesit e bashkive dhe komunave argumentuan se duhet të rriten kompetencat e njësive vendore. Grupi i dytë i cakton qarkut dhe prefektit një rol minimal. Gjatë diskutimeve u ngritën dhe një sërë pyetjesh të tjera ku pjesëmarrësit shfaqeshin të paqartë. Për shembull: Sa përqind e PBB-së do t'i kalojë njësive vendore? Si do të fuqizohen kapacitetet e njësive vendore? A do të përmirësohet cilësia e shërbimeve publike? A do të përcaktohen standartet e shërbimeve publike?

Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve në fokus grupe shfaqti mosbesim tek strategjia. Një nga pjesëmarrësit u shpreh se “me strategjinë do të kemi vazhdimisht probleme pasi ... strategjitë hartohen dhe mbeten në sirtar...”. Njëkohësisht, pjesëmarrësit u shfaqën skeptikë ndaj qëllimeve të qeverisë. U përmend se pushteti qendror nuk është i interesuar t'i lëshojë kompetencat njësive vendore.

Të pyetur nëse ka vullnet politik për të përmbushur objektivat e cilësuar në strategjinë e decentralizimit, 61.4% e zyrtarëve vendorë deklarojnë se po. Një pjesë e madhe e aktorëve qendrorë ndan të njëjtin perceptim. Zyrtarët e komunave dhe zyrtarët me orientim politik të djathtë kanë më pak gjasa të perceptojnë se ka vullnet politik: 88% e zyrtarëve me orientim politik të majtë beson se ka vullnet politik.

Transparenca e qeverisë qendrore

Transparenca e qeverisë qendrore është vlerësuar në bazë të nivelit në të cilin aktorët e kanë konsideruar të hapur procesin e hartimit dhe diskutimit të strategjisë. **Pjesa më e madhe e zyrtarëve vendorë e kanë perceptuar procesin e diskutimit të Strategjisë së Decentralizimit disi të hapur dhe u shprehën disi të kënaqur me mënyrën sesi po ecën procesi i diskutimit.**

Megjithatë, këto rezultate të përmbledhura maskojnë dallime të rëndësishme në perceptime sipas ndarjes bashki dhe komuna dhe orientimit politik të aktorëve vendorë. Nga ana tjetër, në të njëjtën linjë me zyrtarët vendorë, shumica dërrmuese e aktorëve qendrorë i konsideron proceset e hartimit dhe diskutimit disi të hapura ose të hapura.


Rreth 63% e zyrtarëve vendorë janë shprehur se procesi i hartimit të Strategjisë së Decentralizimit ka qenë disi i hapur ose i hapur. Ndërkohë 37% prej tyre janë shprehur se procesi ka qenë i mbyllur³³. Në lidhje me procesin e diskutimit, gjysma (ose 50%) e të anketuarve vendorë e ka perceptuar procesin e diskutimit të strategjisë disi të hapur, krahasuar me 42% prej tyre për procesin e hartimit. Megjithatë, ndërkohë që 27% e të anketuarve e vlerëson procesin e diskutimit të mbyllur, 23% e konsiderojnë atë të hapur. Nëse e mbledh këto shifër me përqindjen e atyre që e konsiderojnë procesin e diskutimit “disi të hapur”, atëherë afro 73% e kampionit e cilëson procesin e diskutimit disi të hapur ose të hapur.

³³ Një proces hartimi ose diskutimi i hapur është konsideruar në pyetësor si një proces ku opinionet e drejtuesve vendorë janë marrë në konsideratë plotësisht. Një proces hartimi ose diskutimi i mbyllur është konsideruar një proces ku opinionet e drejtuesve vendorë nuk janë marrë aspak në konsideratë.

Analiza relacionale tregon se në krahasim me bashkitë, komunat kanë më shumë gjasa t'i cilësojnë proceset e hartimit dhe të diskutimit të strategjisë të mbyllura. Kështu, 67% e komunave në anketë e cilësojnë procesin e hartimit të strategjisë të mbyllur, krahasuar me vetëm 21% të bashkive. Përsa i përket procesit të diskutimit, 50% e zyrtarëve vendorë të komunave e kanë perceptuar si proces të mbyllur krahasuar me vetëm 13% të bashkive.

Zyrtarët me orientim politik të majtë shfaqin më shumë gjasa në perceptimin e procesit të hartimit dhe diskutimit të strategjisë si të hapur. Kështu që, shumica ose rreth 57% e njësive vendore me fitues kandidatin nga “Aleanca për Qytetarin” e cilëson procesin e hartimit të strategjisë të mbyllur, krahasuar me vetëm 12% të “Aleancës për të Ardhmen”. Shumica e njësive vendore ku ka fituar “Aleanca për të Ardhmen” ose rreth 58% e konsideron procesin e hartimit të strategjisë disi të hapur. E njëjta tendencë vërehet edhe për procesin e diskutimit, ku 47% e zyrtarëve ku ka fituar “Aleanca për Qytetarin” e kanë perceptuar si proces të mbyllur, ndërsa shumica dërrmuese ose rreth 73% e përfaqësuesve ku ka fituar “Aleanca për të Ardhmen” e konsideron procesin disi të hapur (shih Fig. 1).

Fig.1 “Procesi i hartimit-diskutimit dhe ndarja sipas aleancave të 2011”



Shënim: Paneli majtas paraqet të dhënat mbi procesin e hartimit të Strategjisë, ndërsa paneli djathtas mbi procesin e diskutimit të Strategjisë.


Përfaqësuesit e shoqatave vendore shprehen mosbesues ndaj procesit të hartimit të strategjisë. Ata theksuan se organizmat konsultativë që synojnë pjesëmarrjen në vendimmarrje nuk funksionojnë pasi vendimet merren në mënyrë paraprake dhe kanë qëllime politike. Njëkohësisht ata u shprehen se strategjia e propozuar nuk ndryshon nga ato të mëparshmet përsa i përket rolit që i është caktuar shoqatave vendore. Një prej pjesëmarrësve theksoi se “Reforma është vetëm territoriale dhe jo administrative.”

Më shumë se gjysma e aktorëve qendrorë shprehen disi të kënaqur ose të kënaqur me mënyrën sesi po ecet procesi i diskutimit të strategjisë së decentralizimit. Përsa i përket zyrtarëve vendorë dallime vihen re në bazë të ndarjes komunë/bashki dhe orientimit politik të aktorëve të interesit. Shumica ose 56% e zyrtarëve prej komunave të vendit deklarohen shumë të pakënaqur ose të pakënaqur me mënyrën sesi po ecën procesi i diskutimit të strategjisë, krahasuar me rreth 23% të bashkive. Nga ana tjetër, 54% e zyrtarëve prej “Aleancës për të Ardhmen” shfaqen disi të kënaqur.

Pjesëmarrja në hartimin e strategjisë së decentralizimit

Ndarja sipas orientimit politik dhe bashki/komunë e zyrtarëve vendorë shfaqet si faktor i rëndësishëm në perceptimet rreth pjesëmarrjes në hartimin e strategjisë. **Pjesa më e madhe e të anketuarve vendorë (47%) percepton se njësia e tyre vendore nuk ka luajtur asnjë rol në procesin e hartimit të strategjisë.** Vetëm 12% e të anketuarve deklaroi se njësia e tyre ka luajtur një rol të rëndësishëm shih Fig. 2).

Fig.2 “Roli në procesin e hartimit të strategjisë së decentralizimit”



Zyrtarët e komunave në përgjithësi perceptojnë se kanë luajtur një rol shumë më të vogël në krahasim me zyrtarët e bashkive. Kështu, 67% e zyrtarëve të komunave perceptojnë se nuk ka luajtur asnjë rol në procesin e hartimit krahasuar me 38% të bashkive. Ndërkaq, 14% e aktorëve vendorë të bashkive deklarojnë se kanë luajtur një rol të rëndësishëm krahasuar me vetëm 6% të komunave.

Zyrtarët me orientim politik të djathtë kanë më shumë gjasa të deklarojnë një rol më të vogël në hartimin e strategjisë krahasuar me zyrtarët me orientim të majtë. Konkretisht, 20% e njësisve vendore ku ka fituar Aleanca për të Ardhmen e cilëson rolin e luajtur në hartim si të rëndësishëm, krahasuar me vetëm 3% të njësisve ku ka fituar Aleanca për Qytetarin.

Analiza përshkruese tregon se 56% e të anketuarve vendorë percepton se SKNDQV përfaqëson interesat e përbashkëta të qeverisë qendrore dhe njësive vendore. Pjesa dërrmuese e aktorëve qendrorë ndan të njëjtin mendim. Megjithatë, është shqetësues konstatimi se **një numër i konsiderueshëm i komunave (45%) deklarojnë se strategjia përfaqëson interesat e qeverisë qendrore**. Në këtë aspekt, pjesëmarrësit në fokus grupe u shprehën se me shumë gjasa strategjia do të çojë në ‘deficiencë përfaqësimi’, sidomos në zonat e thella. Duke qenë se anëtarët e këshillit do të emërohen dhe nuk do të përzgjidhen nga komuniteti, niveli i përfaqësimit do të jetë i dobët. Disa nga komentet që u hasën më shpesh gjatë fokus grupeve janë: “...përfaqësimi me ligjin e ri do të përjetojë regres...” dhe “...do të ketë deficiencë në përfaqësimin vendor me situatën e re të propozuar nga strategjia...”.

Është me interes të përmendet fakti se **ndonëse gjysma e kampionit të aktorëve qendrorë ka qenë pjesë e Grupit Ndër-institucional të Punës, pjesa më e madhe e tyre cilëson se ka luajtur një rol të vogël në hartimin e strategjisë së decentralizimit**.

Impakti i strategjisë së decentralizimit

Zyrtarët vendorë perceptojnë se varfëria dhe papunësia janë problemet kryesore që has njësia e tyre vendore. Ndërsa aktorët qendrorë përmendin mungesën e burimeve financiare, mungesën e kapaciteteve dhe paqartësinë e kompetencave. **Perceptimet mbi impaktin e strategjisë së decentralizimit priret të shihen më pozitive në planin afatgjatë sesa në planin afatshkurtër**. Ndërsa vetëm 18% e të anketuarve mendojnë se strategjia do të çojë në zgjidhjen e problemeve në planin afatshkurtër, 35% prej tyre mendojnë kështu për planin afatgjatë. Pjesa më e madhe e të anketuarve në të dyja rastet është e mendimit se efekti i strategjisë do të variojë sipas problemeve

Në lidhje me efektin konkret të strategjisë së decentralizimit, **impakti i strategjisë në forcimin e financave vendore dhe rritjen e autonomisë fiskale mbetet më i dyshimtë për zyrtarët vendorë**. Konkretisht, 38% syresh shprehen se nuk e dinë nëse strategjia do të çojë në forcimin e financave vendore. Ky tipar nuk shpërfaqet për kampionin e aktorëve qendrorë. Megjithatë, ky shqetësim u vu re dhe gjatë fokus grupeve. Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve theksuan rëndësinë e lirisë financiare të njësive vendore. Për shembull, një prej tyre u shpreh si më poshtë: “Të ketë dorë të lirë të grumbullimit dhe shpërndarjes [së taksave dhe tarifave] duke u miratuar në këshillat përkatëse.”.

Konkluzione

- Përgjithësisht, aktorët qendrorë kanë pasur më tepër akses në dokumentin e strategjisë së decentralizimit sesa zyrtarët vendorë.
- Orientimi politik i njësive vendore shfaqet si faktor ndikues në perceptimet e zyrtarëve rreth aksesit të tyre në informacion.
- Aktorët e targetuar kanë pasur interes të veçantë në përthithjen e informacionit lidhur me strategjinë duke u angazhuar në diskutime në grup ose nëpërmjet hulumtimeve personale.

- Aktorët e interesit përgjithësisht pajtohen me vizionin e përgjithshëm dhe objektivat strategjikë të cilësuar në strategji. Megjithatë, ata shfaqen disi të paqartë me mënyrën sesi do të përmbushen këto objektiva ose në lidhje me aspekte të tjera përmbytësore të strategjisë. Vërehet një valë skpeticizmi dhe mosbesimi në lidhje me përmbushjen e objektivave strategjikë.
- Orientimi politik është faktor ndikues në besimin që kanë palët lidhur me përmbushjen e objektivave të strategjisë. Ndërkaq, komunat të cilat do të suprimohen sipas reformës territoriale shfaqin probleme paqartësie ose mungesë besimi.
- Zyrtarët me orientim politik të majtë shfaqin më shumë gjasa në perceptimin e procesit të hartimit dhe diskutimit të strategjisë si të hapur.
- Ndarja sipas orientimit politik dhe bashki/komunë e zyrtarëve vendorë shfaqet si faktor i rëndësishëm në perceptimet rreth pjesëmarrjes në hartimin e strategjisë.
- Më shumë se gjysma e aktorëve qendrorë shprehen disi të kënaqur ose të kënaqur me mënyrën sesi po ecte procesi i diskutimit të strategjisë së decentralizimit. Përsa i përket zyrtarëve vendorë dallime vihen re në bazë të ndarjes komunë/bashki dhe orientimit politik të aktorëve të interesit.
- Perceptimet mbi impaktin e strategjisë së decentralizimit priret të shihen më pozitive në planin afatgjatë sesa në planin afatshkurtër.
- Një numër i konsiderueshëm i komunave (45%) deklarojnë se strategjia përfaqëson interesat e qeverisë qendrore.
- Në lidhje me efektin konkret të strategjisë së decentralizimit, impakti i strategjisë në forcimin e financave vendore dhe rritjen e autonomisë fiskale mbetet më i dyshimtë për zyrtarët vendorë.

Rekomandime

Dimensioni politik

Rekomandojmë:

- Ridimensionimin territorial të vetëqeverisjes rajonale (qarkut) dhe plotësimin dhe qartësimin e kompetencave, funksioneve, burimeve të tij në bazë të parimit të “subsidiaritetit, kohezionit territorial dhe besnikërisë”.
- Zgjidhjen e problemit të pabarazisë në përfaqësim në këshillat e qarqeve.
 - o Si hap të parë, të shpejtë, dhe pa ndryshime kushtetuese, rekomandojmë gjetjen e një formule të përshtatshme përfaqësimi me bazë numrin e pupullsisë.
 - o Si hap përfundimtar, ne rekomandojmë ndryshime kushtetuese nëpërmjet të cilave të sigurohet që vetëqeverisja rajonale të ushtrohet nga këshilli i qarkut me anëtarë të zgjedhur me votim të lirë, të fshehtë, të barabartë, të drejtpërdrejtë e universal.

- Rregullime në kuadrin ligjor, në statutet dhe rregulloret e funksionimit të këshillave bashkiakë për të siguruar pjesëmarrjen aktive qytetare në vendimmarrje. Nëpërmjet këtyre rregullimeve duhet:
 - të përcaktohen qartësisht dimensionit i çështjeve, i pjesëmarrjes, territorial, financiar, gjinor dhe social.
 - të ridimensionohen strukturat administrative që lehtësojnë dhe mbështesin pjesëmarrjen aktive.
 - të përcaktohen standardet minimale detyruese për informimin, konsultimin, dëgjesa periodike publike, iniciativat qytetare, peticionet dhe komisionet qytetare. Gjithashtu, në këtë kuadër rekomandohet ratifikimi i protokollit shtesë të Kartës Evropiane për të drejtën për pjesëmarrje në punët e një organi vendor.
- Ndryshime në dispozitat ligjore për referendimet vendore me qëllim që ai të jetë një instrument qeverisës i arritshëm dhe i përdorur nga qytetarët dhe në përputhje me traditën më të mirë evropiane.
- Ridimensionim i strukturës drejtuese komunitare (ndërlidhësit) duke përfshirë përcaktimin e misionit, fushës së veprimtarisë së tyre (funksionet dhe kompetencat), mënyrës së zgjedhjes, burimet financiare dhe marrëdhëniet dhe ndërveprimet me institucionet e tjera publike e komunitare.
- Ridimensionim ligjor të marrëdhënive mes autoriteteve vendore dhe qendrore duke pasur si bazë parimet e vetëqeverisjes, subsidiaritetit, ligjshmërisë, diskrecionit dhe të delegimit të kompetencave dhe instrumentat e bashkëpunimit, informimit, konsultimit, mbikqyrjes dhe kontrollit ligjor. Në këtë kuadër, rekomandohet që me ligj të përcaktohen procedurat dhe standardet minimale të konsultimit. Gjithashtu, me ligj të përcaktohet struktura, forma, mënyra e organizimit dhe funksionimin, çështjet për konsultim dhe afatet kohore të procesit të konsultimeve.
- T'u garantohet me ligj njësitë të qeverisjes vendore liria e plotë në ushtrimin e veprimtarisë së tyre dhe të ushtrojnë kompetenca të plotë për funksionet ekskluzive.
- Sugjerohet shqyrtimi dhe një diskutim i hapur i rekomandimeve për Shqipërinë të Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale (rekomandimi 201 (2006) dhe rekomandimi 349 (2013)) dhe përfshirja e tyre në legjislacionin përkatës.

Dimensioi administrativ

- Prodhimin e ujit, pra sistemet me bazë ujore, apo ato me shpime në thellësi, si edhe transportimin e tij nëpërmejt tubacioneve të mëdha kryesore e realizon më mirë qeverisja qendrore se ajo vendore. Qeverisja vendore nuk ka kapacitetet e duhura për ta realizuar këtë shërbim në të gjithë hallkat e zinxhirit të tij.
 - Qeverisja vendore duhet të ketë kompetenca ekskluzive të veta për furnizimin me ujë të qytetarëve, duke e blerë atë nga një pikë depozitë e caktuar e në vazhdim ta shpërndajë atë në familje e biznese duke vendosur edhe sistemin e kontrollit për abuzime. Tarifat me këtë sistem bazohen tek kostot. Në këtë propozim, ka dy aktorë

kryesorë: shitësi i prodhimit (qeverisja qendrore) dhe blerësi i ujit (qeverisja vendore). Bashkitë pasi blejnë ujin e menaxhojnë atë në mënyrë të pavarur dhe atëherë përgjigjen plotësisht përpara qytetarëve për realizimin e këtij shërbimi. Duhet shtuar se gradualisht duhet të fillojnë iniciativa për të lënë alternativë për të lejuar shitës të tjerë privatë. Çmimi i ujit ulet në dy mënyra: konkurenca në tregun e blerjes së ujit nga ana e bashkive dhe menaxhimi i mirë i brendshëm përsëri nga ana e bashkive.

- Duhet të ketë vetëmnjë listë funksionesh të qeverisjes vendore dhe jo më shumë, e cila të quhet “funksionet e veta të qeverisjes vendore”. Edhe në funksionet e përbashkëta aktuale, edhe në ato të deleguara, kompetencat e ndara qartë midis qeverisjes vendore dhe asaj qendrore. Ato duhen përcaktuar si kompetenca të secilës palë vecmas ku të jepet qartë se ku fillojnë e mbarojnë kufijtë e njëjës palë lidhur me palën tjetër. Konsiderohet emergjencë e shkallës së lartë vendosja e standarteve në të gjitha fushat në të cilat kryen aktivitetin pushteti vendor.
- Ligji i ri organik duhet të hartohet në një mjedis konsensual me aktorë dhe faktorë të lidhur me zhvillimin në pushtetin vendor. Përfshirja e të zgjedhurve vendor dhe ekspertëve përkatës është detyrim për të realizuar hartimin e një ligji cilësor.
- Zhvillimi ekonomik lokal duhet të gjejë më tepër vend në legjislacionin e ardhshëm. Rekomandojmë planifikim ekonomik orientues me piketa të qarta për bashkitë e reja, sidomos ato që zotërojnë toka bujqësore. Planet e zhvillimeve ekonomike të territorit duhet të jenë të detyrueshme për t’u hartuar e zbatuar nga bashkitë e reja në të ardhmen.

Dimensioni financiar

- Sugjerohet që treguesit e matshëm për dimensionin financiar të strategjisë (pesha e shpenzimeve vendore ndaj PBB; raporti të ardhura të veta/të ardhura me burim kombëtar) të sqarohen më gjerësisht edhe në pjesën narrative të strategjisë për të shmangur keqkuptime të mundshme mbi nocionet e përdorura. Për shembull, do të ishte me interes të kuptohej nëse fondet nga FZHR, investimet direkte nga FZSHH apo fondet e pritshme nga reforma e zhvillimit rajonal pritet të përlogariten si shpenzime të veta të njësive vendore.
- Do të ishte me vend që strategjia të shprehej në mënyrë të qartë mbi synimin dhe metodën e pritshme të ndarjes së taksave kombëtare.
- Do të ishte me vend që strategjia të përcaktonte qartë synimin për të rritur nivelin e taksave të pasurisë, si një mënyrë e paevitueshme për të rritur efikasitetin e kësaj takes, si edhe për korrigjimin e pabarazive në barrën e kësaj takse në sistemin aktual.
- Në lidhje me transferat ekualizuese, do të ishte pozitive nëse strategjia do të shprehej mbi synimin ose jo për ndryshimin drastik të kritereve në krahasim me sistemin aktual, përfshirë edhe synimin për të futur kritere të reja (për shembull përbërja demografike e cila kërkon strukturë të ndryshme shërbimesh e kostosh), baza për ekualizimin fiskal (për shembull

kalimi drejt një baze tase më të qëndrueshme dhe më lehtë të llogaritshme siç mund të jetë taksa e pasurisë), apo shkalla e ekualizimit.

- Në lidhje me huamarrjen vendore, do të ishte me vend që strategjia të përcaktonte angazhimin për të miratuar kuadrin ligjor për paaftësinë paguese, duke marrë në konsideratë edhe mundësinë që huamarrja të mos jetë e lejueshme në mungesë të një auditimi paraprak të pavarur. Gjithashtu, do të ishte me vlerë t'i jepej përgjigje edhe çështjes së bashkëndarjes së kufirit të borxhit publik mes qeverisë qendrore dhe atyre vendore, në përpjesëtim me pjesën që shpenzimet e tyre kanë në shpenzimet publike të konsoliduara.

Referenca

- Banka Botërore. (2012). Raport Nr: 27885-ALB Shqipëria: Decentralizimi në tranzicion, bashkëpunimi ndërkomunal – Udhëzues për praktikuesit.
- Censusi (2011).
- Dafflon, B. Probleme konceptuale në përcaktimin e funksioneve në vendet e Evropës Juglindore: Rasti i Shqipërisë.
- Dokumenti “Për politikat e decentralizimit në sektorin e arsimit parauniversitar” miratuar me VKM (2004).
- Dokumenti i Politikave për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit në Shqipëri 2014-2018 (Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit).
- ERRU (Enti Rregullator i Ujit). (2014). Raporti Vjetor.
- Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, Vendimi nr. 29, datë 21.12.2006. IDM, Ndërlidhësi Komunitar në Demokracinë Vendore.
- Isaraj, A. Një vështrim Historik i Traditës së Qeverisjes Lokale në Shqipëri.
- Karta Evropiane e Autonomisë Vendore.
- Këshilli i Evropës, Strategjia e Barazisë Gjinore 2014-2017.
- Këshilli i Evropës. The 12 principles for good governance at local level, ëith tools for implementation.
- Komisioni Evropian. (2007). Programming Guide for Strategy Papers, Decentralisation European Urban Charter II; Manifesto for a Neë Urbanity.
- Komisioni i Venecias (2002). Kodi i Praktikës së Mirë në çështjet zgjedhore.
- Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale i Këshillit të Evropës. Demokracia vendore dhe rajonale në Shqipëri.
- Kurti, T. Aspekte të organizimit dhe të veprimtarisë së qeverisjes vendore (1928-1939)
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e miratuar me ligjin nr. 8417, datë.21.10.1998.
- Ligj Nr.9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave”.
- Ligji Nr 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji Nr .9734, datë 14.5.2007 “Për Turizmin”.
- Ligji Nr 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

Ligji Nr 8097, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” kapitulli i referendumeve.

Ligji Nr. 10 107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji Nr. 107/2014 për “Planifikimin dhe zhvillimin e territorit”,hyrë në fuqi 1 tetor 2014.

Ligji Nr. 185/2013, datë 2.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”.

Ligji Nr. 5506, datë 28.12.1976 “Kushtetuta e RPSSH”.

Ligji Nr. 7491, datë 29.4.1991 "Per dispozitat kryesore kushtetuese”.

Ligji Nr. 8518, datë 30.07.1999 “Për ujtitjen dhe kullimin”.

Ligji Nr. 8548, datë 11.11.1999 Për ratifikimin e "Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore”.

Ligji Nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

Ligji Nr. 9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”.

Ligji Nr. 9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”.

Manuali i instrumentave bashkëpunimi ndërkomunal.

Marcou, G. (2007). Kompetencat e autoriteteve vendore në Evropë.

MF, Udhëzimit plotësues Nr 2, datë 09/01/2015 “Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2015”

Misioni i OSBE-ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (2011). Zgjedhjet e Qeverisjes Vendore.

OSCE. (2014). Analiza e Zbatimit të Funksioneve të Përbashkëta të Pushtetit Vendor në Shqipëri.

Paëel Sëianieëicz, Is territorial consolidation – a necessary pre-condition for further decentralization? Protokoll shtesë i Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore për të drejtën për pjesëmarrje në punët e një organi vendor Utreht, 16. XI. 2009

Raporti Fillestar për Bashkëpunimin Ndër-Komunal. (2012).

Recommendation 228 (2007) “Draft additional protocol to the European Charter of Local Self-Government”.

Rekomandimi 201 (2006) “Mbi demokracinë lokale dhe rajonale në Shqipëri”.

Rekomandimi 349 (2013) “Mbi demokracinë lokale dhe rajonale në Shqipëri”.

Report of the European Committee on Local and Regional Democracy (CDLR), “The relationship between central and local authorities”.

Report of the European Committee on Local and Regional Democracy (CDLR),Local authority competences in Europe.

Shutina, D. & Toto, R. (2014). Analiza e Zbatimit të Funksionit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

SIGMA (2015).Assigning Comptences and Functions to Local Self-Government in Four EU Member States: A Comparative Revieë.

Strategjia e Decentralizimit dhe Autonomisë Vendore (1999).

Strategjia e Decentralizimit dhe e Qeverisjes Vendore (2006).

Strategjia Ndërsektoriale e Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore (2011).

V.K.M Nr. 418, datë 25.06.2014, “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”

V.K.M Nr.35, datë 24.01.2007 “Për procedurat dhe format e shitjes së truallit, të pajisur me infrastrukturë, për qëllime tregu”;

V.K.M. Nr.148, datë 13.02.2008 “Për përcaktimin e procedurave për blerjen e banesave, me kosto të ulët, në treg”.

V.K.M. Nr.258, datë 28.04.2005 “Për kushtet, normat dhe standardet që duhet të plotësojnë banesat sociale me qira, të cilat blihen në treg”.

V.K.M. Nr.456, datë 16.4.2008 “Për procedurat e vlerësimit dhe të shitjes, si dhe kriteret e përcaktimit të çmimit të shitjes së truallit familjeve, që përfitojnë banesa me kosto të ulët”.

V.K.M. Nr.53, datë 28.01.2005 “Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm, afateve dhe procedurave për të përfituar strehim nga programet e banesave sociale me qira”.

V.K.M. Nr.814, datë 03.12.2004 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”.

Venice Commission and OSCE/ODIHR “Joint Recommendations on the Electoral Law and the Electoral Administration in Albania” Opinion no. 273 / 2004.

Vokopola, E. (2014). Analiza e Ushtrimit të Funksioneve të Veta të Qeverisjes Vendore në Shqipëri.